



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo -
Territoriale*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.3.2026, ora 14:30

Drejtojnë mbledhjen:

Arbjan Mazniku – bashkëkryetar i Komisionit

Luçiano Boçi – bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.11.2026.
2. Diskutimi mbi kalendarin e detajuar të takimeve për fazën e parë të konsultimeve.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Arbjan Mazniku, Luçiano Boçi, Romina Kuko, Ermal Pacaj, Marjana Koceku, Ermal Elezi, Klevis Jahaj, Bledion Nallbati, Ramadan Likaj, Enno Bozdo, Edmond Haxhinasto, Vangjel Dule, Aulona Bylykbashi, Agron Malaj, Bardh Spahia, Igli Cara dhe Ina Zhupa.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Damian Gjikhuri, Jorida Tabaku dhe Xhelal Mziu.

HAPET MBLEDHJA

Arbjan Mazniku – Të nderuar anëtarë të komisionit, duke ju falënderuar për gatishmërinë për t'u mbledhur me një lajmërim të shkurtër kësaj radhe, këtë mbledhje e kemi thirrur edhe me kërkesë të bashkëkryetarit Boçi, për të diskutuar bashkërisht agjendën specifike të asaj që diskutuam paraprakisht në takimin që zhvilluam, që është agjenda e takimeve dhe e konsultimeve në terren!

Ne kemi bërë një punë paraprake për të diskutuar me bashkitë për data të përshtatshme, që na përputhen edhe neve, edhe bashkive, duke qenë se do të shkojmë në territor për të diskutuar me to, si dhe për një tipologji kalendari për diskutim. Për të thënë të vërtetën, unë pata menduar se diskutimi mes bashkëkryetarëve do të kishte qenë i mjaftueshëm, por, meqenëse zoti Boçi mendon se duhet diskutuar me të gjithë komisionin, jemi më se të hapur për ta bërë edhe në këtë mënyrë.

Ju kemi shpërndarë një dokument të shkurtër, që është propozimi ynë për mënyrën se si mund të organizohet një ditë dëgjësash në territor. Një gjë të ngjashme e patëm edhe për dokumentin që miratuam javën e kaluar, por ideja e një takimi gjatë një vizite në një prej qyteteve-qendër qarku është që, gjatë asaj dite, të zhvillojmë katër takime.

Takimi i parë mendohet të jetë me të zgjedhurit vendorë, me njerëzit që janë të zgjedhur në atë qark, çka nënkupton kryetarët e bashkive, deputetët e qarkut, kryetarin e këshillit të qarkut dhe kryetarët e grupeve të këshillave bashkiakë. I kemi futur qëllimisht kryetarët e grupeve të këshillave bashkiakë, në mënyrë që të sigurojmë pjesëmarrjen e të gjitha forcave politike në këtë takim me të zgjedhurit vendorë. Ky takim presupozohet relativisht teknik, me njerëz që kanë një mandat të të zgjedhurit në atë qark respektiv. Sipas llogarive tona, në varësi të madhësisë së qarkut, në një takim do të ketë 20 deri në 25 pjesëmarrës.

Takimi i dytë është sugjeruar të jetë me stafet teknike të bashkive (pra, bashkitë e atij qarku të përzgjedhin disa njerëz, stafe teknike të fushës juridike, të financave, të urbanistikës, të çështjeve sociale), ku, si anëtarë komisioni, të kemi mundësinë të pyesim jo vetëm të zgjedhurit politikë, por edhe stafet teknike, për problematikat, mbarëvajtjen, gjëra që shkojnë apo që nuk shkojnë në mënyrën sesi funksionojnë kompetencat e pushtetit vendor, financat; të gjitha temat që mbulon komisioni. Pastaj presupozohet një drekë pune me deputetët dhe kryetarët e bashkive të qarkut, ku të ketë një diskutim pak më të përmbledhur.

Më tej do të kemi takim të hapur me komunitetin, ku presupozohet të kemi, në fakt, me propozim të opozitës në mbledhjen e shkuar, ish-zyrtarë të zgjedhur të qarkut, personalitete, përfaqësues të grupeve të interesit, shoqata biznesi, biznese, organizata të shoqërisë civile, akademikë të qarkut... Pra, është një takim më i hapur, me grupe specifike, ku, siç e thashë, me propozimin e opozitës janë shtuar edhe ish-të zgjedhurit e qarkut, qofshin këto në nivel qarku, në nivel kryetarësh të bashkive, apo deputetë që kanë shërbyer më parë në detyra publike, për t'u marrë edhe atyre një opinion mbi mënyrën si duhet të ecim përpara.

Ky është moduli teorik i një dite, i cili mund të jetë i ngjashëm paralelisht me të gjithë gjënë. Parimisht, i kemi kërkuar grupit të ekspertëve të na përgatisin edhe një modul të diskutimeve dhe mbledhjes së opinionit publik në secilin prej takimeve.

Në dokumentin e dytë kemi një modalitet të mundshëm të shpërndarjes në kohë të këtyre takimeve. Propozimi ynë është që komisioni të jetë i ndarë në tri nëngrupe në këtë fazë: një që të ndjekë kryesisht qarqet e Veriut, një qarqet e qendrës dhe nëngrupi tjetër qarqet e Jugut. Në këtë mënyrë, çdo nëngrup presupozohet të ndjekë katër qarqe, dhe e kemi mundësinë që, duke bërë secili nëngrup 4 takime, brenda javës së parë të prillit, të kemi mundësinë t'i mbyllim të gjitha këto faza diskutimesh.

Kishim një agjendë paraprake, që unë e ndava me bashkëkryetarin javën që shkoi, e cila presupozonte edhe një takim të parë në datën 11 mars, pra sot, në fakt, në Berat, për t'i hapur këto diskutime, por, për rrjedhojë të këtij takimi dhe kërkesës, kjo nuk funksionon më, dhe mund ta axhustojmë. Duhet të kemi parasysh se do të duhet të dakordësojmë disa elemente, pra ne, si anëtarë komisioni, ekspertët dhe bashkitë respektive, pala që do të marrë pjesë për t'u dëgjuar në këto takime, dhe duhet të kemi një komunikim edhe me palët respektive.

Këto janë dy agjendat. Jam shumë i hapur që të diskutojmë dhe të dëgjojmë nga ana e të gjithë anëtarëve nëse ka nevojë për axhustime apo për ndryshime, por synimi kryesor, siç shihet nga kjo agjendë, me pak punë dhe pak përpjekje nga secila palë, është t'ia dalim për ta kryer këtë fazë dëgjimore në kohë, pra të mos kalojë kohë pas kohe dhe të ngecim në vend.

Më vjen keq që u bë e disata herë që diskutojmë teknikalitete pa filluar ende nga puna!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Ju përshtëndes!

Është e vërtetë, kjo mbledhje ka rezultuar në bazë të kërkesës që kam drejtuar unë, si bashkëkryetar, por pas takimit që kam bërë me anëtarët e komisionit nga Partia Demokratike dhe pas paraqitjes së një agjende nga ana e bashkëkryetarit, agjendë e cila duket se i kapërcen disa etapa.

Më vjen keq ta dëgjoj vazhdimisht aspektin kohor. Nuk është koha që bën reformën, por është reforma që bën kohën. Në qoftë se ne themi “koha”, kjo, patjetër, presupozon që, hajde, të kryejmë një formalitet, pasi kemi një projekt të gatshëm, kemi një qëllim shumë të qartë dhe na duhet ta mbushim pastaj këtë kohën e përcaktuar me të gjitha elementet, që të duket sikur reforma është serioze!

Ne jemi shumë të angazhuar që reforma, në fakt, të jetë serioze dhe të mos jetë e futur në këmisha force, që duhet të arrijmë këtë dhe atë, duke djegur si etapat, ashtu edhe modalitetet se si mund të punojë ky komision në mënyrë efektive, me qëllim që të kemi një reformë zgjedhore shumë serioze, që pasqyron, në radhë të parë, edhe kërkesat që vijnë nga qytetarët, edhe kërkesat që vijnë nga vetë njësitë vendore, nga vetë bashkitë, por, pse jo, edhe nga komuniteti ndërkombëtar, siç edhe ju e keni arsyetuar në parashtrimet e para. Opozita nuk është aspak kundër pasjes së një agjende, sepse është vijimësia e punës së një komisioni, dhe kemi thënë: po, do të vijojmë me seanca dëgjimore, por seancat dëgjimore duhet të respektojnë disa shkallë të caktuara. Dhe cilat janë këto? Ne akoma nuk kemi konstituuar grupin e ekspertëve, i cili ndërkohë duhet të kishte vazhduar punën për përgatitjen e një raporti vlerësues, të cilit i bashkëngjiten edhe vlerësimet që vijnë. Ka një raport paraprak, sepse janë të dhëna që vijnë nga ekspertët, që i disponojnë deputetët, me të cilat hyjnë në seanca dëgjimore, dhe sigurisht që ka edhe një metodologji.

Unë sot e dëgjoja për herë të parë që grupet e dëgjesave do të jenë 25. Unë jam bashkëkryetar dhe në qoftë se nuk do ta kisha kërkuar këtë mbledhje, nuk do ta kisha mësuar, sepse asnjë nga anëtarët e opozitës nuk e di që numri i atyre me të cilët ne do të zhvillojmë dëgjesa është 25, minimalisht apo i parashikuar.

Ndërkohë, në mbledhjen që ne kemi zhvilluar kemi dalë në konkluzionin që duhet të jetë një palë e tretë, në bazë edhe të një projekti, të cilin ne e kemi kërkuar si bashkëkryetarë tek Ambasada Zvicerane, që të përkujdeset dhe të merret me organizimin e agjendës së dëgjesave të komisionit.

Unë mendoj se dëgjesat nuk mund të nisin ...

Jo për të fituar kohë, se unë nuk e kuptoj pse na akuzoni për këtë. Çfarë kohe do të fitojmë? Ne nuk jemi në fitimin e kohës? S'ka arsye që ne të fitojmë kohë. Ne duam të bëjmë reformën.

Pra, dëgjesat nuk mund të nisin pa ndërtuar faqen *web* të komisionit dhe elementë të tjerë, të cilët ndihmojnë në komunikimin me publikun, sepse ne po bëjmë në këtë formë një reformë të mbyllur politike brenda përfaqësuesve tanë politikë, ndërsa ai që është i interesuari kryesor nuk merr asnjë informacion. Ne bëjmë takime dhe dëgjesa në qarqe me këshilltarë, me “teknicienë” dhe gjithçka mbyllet brenda zyrave të këtyre bashkive, kur dihet se në shumicë, për arsye të thëna nga ne dhe të pranuar nga faktori ndërkombëtar, dominohen nga Partia Socialiste.

Nuk mund të thuash që këshilltarët janë staf teknik. Ç' staf teknik janë ata? Ata janë njerëz politikë dhe diskutimi është qartësisht politik. S'mund të thuash se njerëzit që vijnë nga administrata e bashkisë janë staf teknik, se o ka kritere *rigide* politike për të zgjedhur ata që punojnë në bashki në Shqipëri, o nuk ka në asnjë vend tjetër. Konkurrohet me qeverinë qendrore, por kjo është e vërteta, që të gjithë e dimë dhe duhet të bëjmë sikur nuk e dimë. Jo, fare!

Prandaj, ne e kemi kërkuar këtë mbledhje me qëllimin që komisioni të hyjë në rrjedhë normale, pa u vendosur në kufizime. Duam të arrijmë kohën? Po, patjetër. Jemi të angazhuar? Po, sigurisht që jemi të angazhuar, brenda logjikës së rrjedhjes së etapave të punës së një komisioni që vërtet realizon dëgjesa reale, realizon një punë efektive, jo të paragjykuar mbi bazën e një rezultati tashmë të përcaktuar, por të një rezultati që vjen si pasojë e të gjithë punës së komisionit. Kjo është ajo që duam të ndërtojmë.

Ne duhet të ecim në këtë logjikë, që mua më duket normale. Aq më tepër, të mos harrojmë një element shumë të rëndësishëm: dëgjesat nuk mund të bëhen vetëm në këto ambiente të mbyllura dhe nuk mund të bëhen në ambientet e bashkisë iks apo ipsilon, qoftë e majtë, qoftë e djathtë, por duhet të jetë vend krejtësisht neutral. Siç e thashë, organizatorët janë përtej përfaqësimit politik. Pariteti i pjesëmarrësve është i domosdoshëm. Në qoftë se bëhet me 25, e bëjmë 26 dhe ne kemi të drejtën të thërrasim 13 përfaqësuesit tanë, ju 13 tuajt, se në paritet do të shkojmë, dhe të vijojnë diskutimet. E rëndësishme është që diskutimet të jenë efektive, të jenë *online*, të jenë të shfaqura, që publiku i interesuar të jetë në ndjekje të punës së komisionit. Ne nuk mund të bëjmë 12 takime brenda një dite (tri qarqe nga katër takime për secilin), dhe në media të dalin vetëm fragmente, vetëm pamjet tona që flasim dhe ngremë teza, ndërkohë që publiku nuk merr asnjë informacion nga kjo gjë. Ne duam t'i bëjmë me qarqe, ku në një ditë të

jemi në një qark të caktuar. Dakord edhe për grupet e deputetëve, se edhe ne i kemi ndarë, edhe sipas tematikave, edhe sipas rajoneve gjeografike më shumë. Ka deputetë që duan të marrin pjesë në gjashtë takime, sepse janë të interesuar për shkak të aktivitetit politik, të interesit të tyre personal. Unë kam kërkesa nga ekspertë dhe nga deputetë që të marrin pjesë në 12 qarqe, por në qoftë se ne realizojmë takime brenda një dite në 3 qarqe njëkohësisht, kjo nuk funksionon, për më tepër nuk ekziston as logjistika e zhvendosjes. Dalim në një element shumë të vogël, por që është realisht i tillë.

Ajo që unë e konsideroj më kryesore është që kur thuhet “dëgjesa publike”, (po e heq fjalën “dëgjesë” dhe po lë vetëm “publike”), kuptohet më gjerë sesa një këshilltar, sesa kryetarë bashkish, sesa ish-kryetarë bashkish. Ka publik shumë të interesuar për këtë reformë, që i shkruajnë edhe komisionit, me letra deri tani, por që do t’i shkruajnë edhe *online* në një moment të dytë, ku kërkojnë që të bëhen dëgjesa nga ana jonë. Në qoftë se ne i sulmojmë dëgjesat, i mbyllim, atëherë s’do të kemi as kohë për të konsideruar kërkesat e tyre, as kohë për të zhvilluar dëgjesat me problemet që ato pasqyrojnë. Unë që sot kam kërkesa nga Klosi, nga Maqellara, nga Burreli, nga Nivica, nga Himara, se nuk dinë ku të përplasen, nuk dinë ku të ikin.

Në formë të tillë kaotike nuk mund të vazhdojë ky komision dhe prandaj dua që të jemi të kujdesshëm. Të ndërtojmë komunikimin me publikun nëpërmjet këtyre elementëve, sepse atje ku duam ne themi që konsultat publike ...

Jo më larg se dje, te diskutimi i planit strategjik të Kuvendit na u referua që konsultat publike për ligjin janë *online*, kushdo hyn online, ndërkohë që këtu ne nuk i bëjmë *online*. Ajo paraqitet si arritje, si strategji e punës së Kuvendit. Ku është strategjia e punës së Kuvendit? Ne pse nuk bëjmë konsulta *online* për të gjitha gjërat ose komunikime të tilla?

Prandaj, përgjigjja jonë është e tillë: po për agjendën, po për takimet, por për agjendën pa definuar në formën që ju na e keni sjellë, por duke e diskutuar dhe duke e vendosur pa pasur një trysni. Të jeni të bindur se pa pasur trysninë e kohës ne do të ecim më shpejt sesa duke pasur mbi supe trysninë e kohës. Të realizojmë dëgjesat, për të cilat, siç e thashë, ka kërkesa nga Klosi, Burreli, Mirdita, por edhe nga qytete të tjera dhe që në vazhdimësi do të shtohen, sepse ka shumë komunikime. Po ashtu, Belshi ka interes, Cërriku ka interes, Përrenjasi ka interes.

Ne duhet të jemi shumë të ndershëm me komunitetet, me njerëzit. Nuk mund të themi se jemi ne ata që e dimë se si bëhet kjo reformë. Jo, sepse mbase nga ata njerëz të thjeshtë mund të dalin ide shumë gjeniale, që ndjekin një vazhdimësi shpirtërore,

historike, traditash, që ndoshta ne këtu si politikanë nuk i kemi përjetuar, nuk i njohim dhe nuk i dimë. Pra, kemi shansin më të mirë, më të bukur, më të mundshëm që të dëgjojmë komunitetet dhe të marrim në konsideratë gjithçka që ata duan të pasqyrojnë dhe t'i paraqesin si kërkesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, e dimë, ka një defekt, e diskutuam këtë, por do të regjistrohet dhe do të transmetohet. Prandaj, të gjitha diskutimet të jenë sikur mbledhja është *online*. Dakord? E di që ka një zhvendosje të fokusit në këtë rast.

Atëherë, ta fillojmë nga mazhoranca apo nga opozita?

Zoti Elezi, fjala për ju.

Ermal Elezi - Unë nuk e shikoj njësoj këtë çështje. Për mua koha është shumë relevante, pa diskutim pa prekur cilësinë, por kemi humbur tashmë mbi katër muaj. Pra, nuk e di kur do të fillojmë nga puna, se s'po fillojmë, po diskutojmë akoma si do të punojmë.

E dyta, nuk e di këtë gjënë që thatë, që takimet na i organizojnë organizata dhe donatorë. Ne jemi deputetë të Republikës së Shqipërisë dhe kemi tagrin t'i organizojmë vetë dëgjesat. Nuk e di pse duhet t'i organizojë një palë e tretë, a thua se kemi nevojë për ndonjë gjë. Ne të gjejmë mirëkuptimin dhe mund t'i organizojmë edhe në formatet që ju dëshironi.

Po ashtu, vijmë vetëm materiale që janë propozimet tona, ndërkohë që s'kam parë një rresht të shkruar si propozim nga opozita. Domethënë, vijmë këtu vetëm për të marrë kohën që të debatojmë si ta kritikojmë dokumentin që paraqitet nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, por, nga ana tjetër, nuk kemi alternativën e përgatitur se çfarë mendoni ju konkretisht. Ju i thatë ca gjëra tani, mbi disa mund të biem dakord, por s'ka propozim. Nëse vazhdojmë me këtë lloj ritmi, unë besoj se nuk e mbarojmë as në vitin 2040. Domethënë, nevoja është që ne të punojmë sipas mandatit që na ka dhënë Parlamenti. Parlamenti na thotë se deri në korrik duhet të kemi këtë produkt dhe ne duhet të dalim me një produkt, sepse këtë vendim kemi marrë në mënyrë të përbashkët. Pastaj, në rast se do të gjendemi në afatet që ne e kemi kryer me intensitet maksimal dhe nuk na del koha, le ta diskutojmë atëherë, por ne s'po e nisim njëherë.

Kështu që, jam shumë i shqetësuar dhe do të dëshiroja që të gjithë ne të nisim dhe të përcjellim sa më shpejt formatet *online*, edhe në bashkitë ku është nevoja, dhe t'i sjellim ato në tryezat tona. Ndërkohë, puna nga ekspertët ka filluar dhe disa materiale përgatitore i kemi të bollshme, sepse është bërë njëherë ky ushtrim (është bërë në 2022-

2023-shin), kur kanë qenë edhe disa prej jush, kur ka pasur komisione të përbashkëta; ka studime, ka analiza, ka një sërë materialesh që ne i kemi. Nuk është se po shkojmë dhe s'kemi asgjë. Kështu që, ju lutem shumë të vazhdojmë, ndryshe më duket sikur kthehemi gjithmonë në pikën zero.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Atëherë, në raport me kohën unë dhe kolegët e mi jemi shumë të shqetësuar. Sigurisht, ne duam të kemi një përfundim në kohën e duhur logjike, politike dhe zgjedhore, sepse ky është afati, që ndoshta nuk është koha e thënë nga ikusi apo ipsiloni, s'ka rëndësi, dhe ajo mund të jetë një kohë kufi.

Ndërsa për çështjen e marrjes së vendimeve, të agjendave, që dikush sjell material të shkruar dhe ne nuk po e sjellim të shkruar, nuk ka ceduar për arsye se ne nuk dimë të shkruajmë dhe s'dimë të ndërtojmë agjenda me orare dhe me ditë, se është gjëja më e thjeshtë që mund të bëhet, çështja është që agjenda është kompetencë e këtij komisioni, e përcakton dhe e diskuton ky komision, ndërkohë që ky komision është mbledhur herën e fundit dy javë të shkuara ose ndoshta edhe më shumë. Në këtë rast ka qenë mungesa e iniciativës për ta mbledhur Komisionin, jo për të shkruar dhe për t'i definuar, sepse, nëse do ta shkruaja unë dhe do t'jua sillja, unë do të hezituoja, pasi nuk mund ta sjell pa e diskutuar bashkë. Ja ku dolëm te diskutimet që po, kjo agjendë duhet të bërë, por në bazë të respektimit të disa etapave për të cilat biem dakord edhe bashkë.

Edhe për punën e ekspertëve, unë nuk jam marrë ndonjëherë me reformën territoriale, megjithëse kam përvojë të gjatë politike në Parlament, nuk ka qëlluar rasti, por kjo nuk do të thotë që unë të supozoj se ka materiale të punuara nga të tjerë në kohëra të tjera. Të paktën për punën që do të bëj këtu, patjetër do t'i ballafaqoj bashkë me të dhënat që sjellin ekspertët në momentin e tanishëm, sepse është alogjike që reforma të mos ketë historinë e vet. Ka edhe në vitet 2014-2015, edhe në vitin 2022, por sigurisht unë dua të dhënat e freskëta, sepse, nëse unë vij në dëgjuesë me të dhënat e vitit 2022, unë direkt kam bërë autogol i pari. Unë nuk mund të nisem të bëj biseda të reja me të dhëna të vjetra, të hedh ide të reja. Patjetër do t'i ballafaqojmë, zoti Elezi, jam shumë dakord, por ne këtë punë duhet ta kishim bërë. E di që ka pengesë nga Kuvendi, nuk është faji juaj në këtë rast. Nuk ngarkova asnjë me faj. Kuvendi duhet të kishte nxituar, të ishin shpejtuar vendimet e Byrosë, të ishin mbledhur ekspertët. Është lënë që t'i mblidhnim dhe ekspertët të merrnin mandatin. Ata nuk e kanë marrë mandatin. Ndoshta ata kanë punuar, tuajit dhe tanët, i kam mbledhur unë. I kam mbledhur, i kam thirrur, si njerëz vullnetarë. Ne jemi politikanë, ata nuk janë politikanë.

Ata kanë punuar me pasion, sepse e kanë dëshirën, por ne duhet t'u japim një autoritet. Ata nuk vijnë këtu, nuk janë prezentë, përveç Telitit, për shembull. Pse të mos jenë ekspertët? Ata kanë dëshirë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet tona, disa për njohuri, disa për të marrë pjesë në debat, prandaj themi të mos i djegim etapat. Nëse kemi nevojë për vendim të përbashkët në Byro, iki unë së bashku me bashkëkryetarin, u biem dyerve të rënda të Parlamentit dhe t'i hapim. Po na pengojnë ata, nuk po e pengon opozita mazhorancën dhe anasjelltas, të them të drejtën. Mbi bazën e kësaj, ne të jemi seriozë, sepse dukemi shumë kaotikë, ka rrëmujë. Do të marrim ekspertët dhe ju do të thoni: kush është ky ekspert? Unë do të them që ky është eksperti im, ndërkohë që ne të gjithë duhet t'i njohim ekspertët, se ata kanë mandatin e dhënë nga ne, si komision, prandaj e thashë që ky komision ka nevojë për seriozitetin e duhur.

Gjithashtu, mua nuk më duket logjike të bëjmë 12 takime në 3 qarqe për një ditë. Jo, nuk mundemi. Është mbingarkesë shumë e madhe informacioni. Të kemi një qark në ditë. Ne nuk jemi vetëm anëtarë të komisionit të reformës zgjedhore, kemi angazhime politike të jashtëzakonshme edhe brenda Parlamentit, por edhe si politikanë, jashtë Parlamentit. Ndoshta ka opozita më shumë, mazhoranca më pak, ndoshta mund të keni edhe ju më shumë, prandaj duhet të jemi bashkë, të biem dakord me këtë agjendë, të përcaktojmë edhe kohën, edhe mundësinë e zëvendësimit. Them që është punë e përbashkët, por mua më vjen keq kur e dëgjoj që kanë punuar ekspertët tuaj dhe ekspertët tanë. Atëherë, ata nuk janë ekspertë, ata janë politikanë me termin "ekspert", sepse unë di që këta duhet të punojnë bashkë, sepse reforma do të ketë konkludim të përbashkët. Do të kenë akses në informacione, në *database*-n e qeverisë, duhen të dhëna nga Instati, të freskëta, reale, të vërteta, në institucione që ata i besojnë dhe ne marrim vendime që të mos kenë pengesa. Kështu rakordohet puna dhe pastaj vazhdojmë me dëgjesat. Me duar në xhepa, me dosjen e vitit 2022 nën sqetull, do t'i them këshilltarit të Bashkisë së Shkodrës që të na japë pak mend ai se si mund të qëndrojë Shkodra, bashkë apo veç. Kjo punë nuk shkon.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Atëherë, bashkëkryetari herë pas here më ka kritikuar për faktin që nuk duhet të flasim pas çdo folësi, por u ngritën disa çështje që duhen adresuar përpara se t'ju jap fjalën. Ju kërkoi ndjesë, por u bë 15 minuta bisedë! Dua të them 2-3 gjëra për të qartësuar publikun që na ndjek.

Së pari, në mënyrë sistematike, nga dita e parë që është krijuar komisioni, qysh në mbledhjen e parë kemi sjellë një agjendë për të dakordësuar disa pika kyçe ku duhet

të kalojë puna jonë. Më pas, kemi sjellë një dokument të strukturuar për një seri punësh që duhen bërë dhe kemi rënë dakord për një pjesë të këtyre gjërave. Tani, në mënyrë sistematike, sillni një temë të një hipoteze: janë gjërat gati, i keni bërë gjërat gati. Ndërkohë, për këtë ka vetëm një hipotezë të ngritur nga mosbesimi, nga paranoja, nuk e di nga çfarë. Për këtë që them unë, që opozita në mënyrë sistematike e ka vonuar e vonuar për ta çuar këtë proces në kalendrat greke, ka fakte të ndodhura tashmë. Fillimisht humbëm 2 muaj, u mblodhëm, miratuam agjendën, kalendarin tërësor të punës. Nëse ne do të shkojmë te pika që do të duhet i gjithë komisioni për të diskutuar nëse do të jemi në datën 3 apo në datën 5, në datën 13 apo 12, për të shkuar në një qytet të caktuar, atëherë kjo gjë nuk mbaron as për 100 vjet. Këtu duket që ka një agjendë të caktuar për të mos bërë punë dhe nuk ka asnjë element të diskutimit. Nëse ne do të flasim për ristrukturimin e pushtetit vendor në Republikën e Shqipërisë, këtë nuk e bëjmë dot pa folur me kryetarët e bashkive dhe me të zgjedhurit vendorë. Pra, kur unë them që për të shkuar në qarkun e Shkodrës duhen 25, 27 apo 32 vetë, ky është një produkt i kësaj listës këtu. Janë kaq kryetarë të bashkive, kaq deputetë, një kryetar i këshillit të qarkut, një prefekt, dy apo tre kryetarë grupesh për grupet e këshillit bashkiak dhe del një produkt numri. Këta janë njerëz të cilët kanë një mandat dhe sigurisht, kur ne të fillojmë diskutimin, do të diskutojmë edhe me qytetarët, por pa dyshim diskutimi fillon me njerëz të cilët kanë një mandat politik. Besoj se ne nuk mund të themi që nuk do të shkojmë të flasim apo të bisedojmë me personat e zgjedhur në këto vende, pavarësisht se kush është zgjedhur. Me të drejtë na kërkua të përfshijmë në këto diskutime ish-zyrtarët e zgjedhur dhe ne thamë që jemi dakord, patjetër t'i përfshijmë, ish-deputetë, ish-kryetarë të bashkive, sepse edhe ata kanë opinionin e tyre, por çdo herë që ne ecim një hap drejt punës, del një problem tjetër për të mos bërë punë, pra për të mos filluar një proces diskutimi.

Ngritët çështjen e faqes së *web-it*, por faqja e *web-it* nuk na duhet për të bërë një bisedë me të zgjedhurit vendorë të Shqipërisë, sepse ne shkojmë në qytet, ulemi, i thërrasim këtu dhe e bëjmë një bisedë me këta njerëz. Nuk na duhet një faqe *web-i* për të folur, për të kuptuar nga drejtorët e financës së bashkive se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon me financat vendore, për të folur me ata që merren me shërbimet sociale për të kuptuar se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon me ofrimin e shërbimeve sociale, për të folur me njerëzit e urbanistikës për të kuptuar se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon me mënyrën se si funksionon urbanistika në këtë vend. Duke pasur mundësinë të flasim me këta njerëz, ne kuptojmë problemet që duhet të zgjidhim. Nuk na pengon asgjë që ne ta

bëjmë fazën e parë të dëgjesave me këta njerëz. As fakti që nuk janë formalizuar ekspertët nga ana e Byrosë, ushtrim që shpresoj dhe besoj të ndodhë këto ditë, nuk na pengon ta fillojmë punën, sepse këto janë procese që ndodhin paralelisht.

Nga ana tjetër, lidhur me diskutimin që ta ndajmë këtë ushtrim sërish në kohë, nuk besoj se në diskutimin që ne do të bëjmë në Vlorë duhet të jetë i gjithë komisioni, kur atë mund ta përfaqësojë një grup nga Partia Socialiste, një grup nga opozita, për ta bërë diskutimin. Nëse do të ndodhë një diskutim në Shkodër në të njëjtën ditë, nuk ka asnjë problem, sepse të dyja këto vendosen në faqet e *web*-it edhe të Parlamentit, edhe në faqet tona personale, edhe në faqen e komisionit. Kush do t'i shohë dhe t'i ndjekë i sheh, sepse teknologjia na e ka dhënë këtë mundësi. Ne nuk kemi pse të presim të gjithë të bëhet takimi në Vlorë dhe pastaj të presim të gjithë të bëhet takimi në Gjirokastrë apo në Kukës, ndërkohë, duke u bërë këto ushtrime paralele, e mbledhim informacionin paralelisht, i mbledhim opinionet paralelisht dhe ecim përpara me procesin.

Sërish, kjo logjikë më çon mua të besoj atë që thashë në fillim që këtu, në vend të kemi një agjendë dhe një gatishmëri për të filluar punën, në fakt, kemi një agjendë për ta shtyrë e për ta shtyrë javës tjetër, pas një jave, pas 5 ditësh, pas 2 ditësh, të takohemi edhe një herë që të flasim edhe një herë, që ne të mos e fillojmë punën dhe ta çojmë reformën në kalendrat greke. Për fat të keq, tashmë kemi prova për këtë gjë. Unë përsëri në mënyrë sistematike jam i gatshëm të jap “gjethen e dafinës”. Çdo kërkesë që opozita ka sjellë e kemi pranuar, por duhet të fillojmë punë.

Luçiano Boçi – Zoti Mazniku, atë gjethen e dafinës mbajeni për vete, se ne nuk kemi dalë ndonjëherë në foto çullakë, kështu që ta gëzoni dhe përdoreni në mënyrë efikase!

Ndërkohë, të mos dalim në përsëritje, sepse për këtë komplotin që ju paskeni zbuluar, nuk e di nëse ju kanë ndihmuar organet e shërbimit informativ shqiptar për faktin që ne po bëjmë një komplot kohor për të sabotuar reformën territoriale. E heqim këtë lloj retorike, sepse nuk shkon. Keni prova dhe fakte, këtë nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deklaratat tuaja janë drejt këtij orientimi: shumë prova dhe fakte. Sigurisht, provat dhe faktet janë pretendime të drejtuesve tuaj të bashkive në zona të caktuara, të cilët e dinë shumë mirë se ku do të shkojë reforma territoriale, dhe nuk hezitojnë t'i ndajnë edhe me njerëz të tjerë apolitikë apo me njerëz që mendojnë se nuk kanë lidhje me opozitën. Shqipëria është vend i vogël, normal. Ka edhe deklarata të tjera të drejtuesve tuaj politikë, por nuk ka provë më të madhe se sa kur ju themi: ejani ta bëjmë

brenda një kohe të shkurtër! Unë thashë që nuk e prodhon koha reformën. Jo, nuk është koha objektiv, reforma është objektivi dhe koha është element veshës i reformës. Koha mund të jetë korriku dhe shumë mirë të jetë korriku, nuk kemi fare asnjë kundërshtim, por t'i ndërtojmë etapat.

Thatë se duhet komunikimi *online*, por nuk e kemi komunikimin *online* që të fillojmë dëgjesat. Ne sot do të ishim në Berat. Ku do ta komunikojmë *online* ne për publikun e Beratit, për shembull? Ne nuk e kemi faqen e *web-it*. Fakti që ne po e kërkojmë është blasfemi? Jo, fare. Ne po kërkojmë të bëhen këto etapa. Ne i kemi kërkuar Ambasadës Zvicerane që nëpërmjet projektit “Bashki të forta” të ketë një mbështetje nga ana e tyre, edhe për logjistikën, edhe për faqen e *web-it*, edhe për organizimin e takimeve.

Nuk e përmenda fare në fjalën time që të mos kemi takime me kryetarët e bashkive. Unë thashë se jemi dakord, por të bëjmë edhe me qytetarët. Është më e rëndësishme të bëjmë me qytetarët, por nuk thashë që nuk vlejnë kryetarët e bashkive. Pra, t'i marrim gjërat në kuptimin e drejtpërdrejtë të thënies së tyre, të mos i veshim me ato që ju përmendët për ne, si paranoja, paragjykimet e të tjera. Nuk kemi asnjë lloj paragjykimi, asnjë lloj paranoje, asnjë lloj dëshire për të penguar, përderisa unë faktova këtu dhe është e vërtetë që grupi i ekspertëve po punon nga mbledhja e fundit, se ne i kemi thirrur, i kemi ndarë edhe sipas tematikave dhe detyrave, por është ezauruar koha e vullnetarizmit. Ata nuk kanë status dhe nuk na shkon neve pa u dhënë një status, sepse këta njerëz do t'i kemi bashkë në dëgjesa. Unë po kërkoj ca elemente formale, reale, që ndihmojnë ecjen e punës sonë përpara. Të mos mbetemi te këto diskutime. Duhet të pranojmë që disa gjëra duhet të kalojnë në etapat e tyre. Janë burokraci, por janë edhe procedura. Megjithatë, sepse e di që do të hyjmë në këto debate, kam një kërkesë nga anëtarët e opozitës: kërkojmë 10 minuta pushim, sa të diskutojmë dy-tri çështje që dolën tani dhe i kemi themelore për të marrë edhe ne një vendim. Besoj se na mirëkuptoni, vetëm 10 minuta dhe pastaj vijojmë. Dakord?

Faleminderit!

(Pas pushimit.)

Luçiano Boçi – Atëherë, rifillojmë mbledhjen pas pushimit të kërkuar nga ne. Me qëllim që të shmangim edhe debatet dhe diskutimet, duke përsëritur edhe qëndrimet, kemi një propozim konkret në raport me agjendën dhe modalitetet e zhvillimit të dëgjesave publike dhe të dëgjesave me kategori të caktuara, si: kryetarë bashkish, këshilltarë, ish-kryetarë bashkish apo personalitete të kësaj fushe, sigurisht,

duke respektuar të gjitha etapat që unë i ngrita si shqetësim, të cilat nuk janë respektuar. Duhet t'i bëjmë me urgjencë, të gjejmë të gjitha mënyrat që të ecim me shpejtësi. Që të kursejmë edhe kohën dhe të kapim atë të domosdoshmen, që nxirret këtu edhe si justifikim, ne kemi si propozim që dëgjesat të realizohen në Kuvend. Dëgjesat për kryetarët e bashkive, për këshilltarët, ish-kryetarët e bashkive të transmetohen *live* në të gjitha rastet, ku i gjithë Komisioni i dëgjon kryetarët e bashkive, ballafaqon tezat, idetë dhe mendimet e tyre. Ndërsa dëgjesa publike të konsiderohen dhe të bëhen vetëm ato që vijnë si kërkesa nga komunitetet. Për organizimin e tyre, sigurisht, duhet të merret një palë, në këtë rast i kemi kërkuar ndihmë ambasadës zvicerane nëpërmjet projektit "Bashki të forta". Transparenca është maksimale, koha fitohet. Mendoj që ta fillojmë që ditën e premte, në qoftë se i kapërcejmë etapat e uebit dhe të palës që do t'i organizojë dëgjesat publike. Këto i kemi në kompetencë ne, nuk kemi nevojë për palë të tretë, i thërrasim dhe që ditën e premte jemi të gatshëm t'i nisim pa vonesë dëgjesat për reformën territoriale.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Që ta kuptoj: propozimi është që në datën 13 mars, ditën e premte, në vend që të shkojmë t'i takojmë grupet në Shkodër, duhet ta sjellim Shkodrën këtu.

Enno Bozdo – Një pjesë e këtyre takimeve të propozuara nga ana juaj janë seanca dëgjimore, që komisioni dhe komisionet e tjera parlamentare, sipas traditës, i thërrasin njerëzit, dëgjojnë, bëjnë pyetje-përgjigje dhe njerëzit ikin, por ato që quhen dëgjesa të mirëfillta publike, bëhen pranë komunitetit dhe ne shkojmë pranë komunitetit.

Për të mos humbur kohë, megjithëse unë nuk mendoj se jemi në kushtet e humbjes së kohës (dhe do të them edhe diçka në lidhje me mënyrën sesi po punohet deri tani, por po e lë në fund), seancat dëgjimore me këta që keni listuar ju, mund t'i fillojmë sa më shpejt të jetë e mundur, qark pas qarku, edhe bashki pas bashkie, në qoftë se do të mendohet se do të bëhen. Këtë mund ta fillojmë. Këto janë personazhe dhe personalitete që e njohin mirë pushtetin vendor; ju gjykoni, ne gjykojmë dhe biem dakord për numrin, për kompozimin dhe ecim përpara. Takimet në komunitet duhet t'i organizojmë minimalisht nga një për çdo qark dhe atje shkon komuniteti me lajmërimet publike, me kërkesa, duke marrë në shqyrtim kërkesat e uebit, kërkesat që mund të vijnë nëpërmjet postës së zakonshme apo *email*-it dhe përcaktohet agjenda. Pra, sipas agjendës, dëgjojmë edhe komunitetin, bëjmë edhe seancë dëgjimore me njerëz që e

njohin problematikën e pushtetit vendor. Ndarja në këtë mënyrë na lejon, së pari, të ecim përpara; së dyti, e bën shumë transparent të gjithë procesin; së treti, lejon që pjesa më e madhe e takimeve tona të jenë transparente dhe e transmetueshme nëpërmjet mediave, sepse, duke qenë në Tiranë, na e lehtëson edhe ne punën që të mos kemi zhvendosje pa fund, si dhe eliminojmë edhe drekat e punës, që besoj se të gjithë e dimë se janë çaste për të shtuar kile më shumë sesa për të diskutuar.

Pra, ky është propozimi dhe mendoj se jemi në terren të përbashkët këtu, sepse i japim zgjidhje çështjes.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Po, zoti Spahia.

Bardh Spahia – Kolegë, objektivi kryesor dhe synimi kryesor i këtij komisioni duhet të jetë rezultati final, por ky rezultat nuk duhet të arrihet nën presionin e kohës. Mendoj se të arrijmë një produkt të duhur, duhet të ndjekim hapat e duhur, pa anashkaluar dhe pa bajpasuar disa prej momenteve thelbësore në punën e këtij komisioni, siç janë dëgjesat publike.

Unë nuk e kuptoj, marr shkas edhe nga fjala e kolegut, sesi mund të realizohet ose sesi mund të keni ju një dokument gati në këtë pikë ku jemi ne, pa filluar akoma me dëgjesat publike. Pse duhet të kemi ne një propozim në këtë moment, ndërkohë që nuk kemi filluar akoma me dëgjesat publike?! U tha më parë këtu që ne kemi avancuar, ne kemi projekt dhe ju nuk keni një propozim akoma.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ashtu u tha.

E tha me të drejtë zoti Boçi që ky komision nuk është mbledhur për të analizuar dhe për të punuar mbi një dokument të 2022-shit sepse, sikur asgjë të mos jetë, ndryshimet janë të jashtëzakonshme, minimalisht demografike, por edhe....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju e keni këtë, por e thatë edhe vetë. Mendoj që ne duhet të fokusohemi tek organizimi siç duhet i dëgjesave publike. E para, dhe këtu po marr prapë shkas nga diskutimi haptas juaji, unë mendoj që dëgjesat publike, në respekt edhe të frymës së paritetit që përfaqëson ky komision, nuk mund të organizohen në ambiente të bashkive.

E dyta, mendoj se dëgjesat publike janë krejtësisht të pavlera, në qoftë se realizohen vetëm me specialistë të institucioneve të bashkive, pasi të gjithë e dimë dhe është e kotë të bëjmë sikur nuk jemi koshientë që specialistët e bashkive janë krejtësisht persona, në mos politikë, të paktën, të influencueshëm politikisht nga drejtuesit e

institucionit. Dhe të shkojmë aty të harxhojmë kohën që të dëgjojmë nën petkun e specialistëve mbrojtjen politike të njërit variant, nuk shkon.

Po ashtu, mendoj që edhe organizimi në frymën e paritetit të dëgjesave publike, duhet bërë nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv, ku sigurohet informimi i qartë i pjesëmarrjes së qytetarëve, mundësisht, edhe i specialistëve, por pa përjashtuar edhe qytetarët, pasi të gjithë, të paktën kush është marrë me pushtetin lokal, e ka krejtësisht mirë parasysh impaktin e fortë që kanë këto vendimmarrje, kryesisht të qytetari dhe kryesisht të qytetarët e disa zonave apo njësive administrative, të cilët preken direkt nga çdo vendim që do të marrë ky komision.

Të tjerat i ezauroi zoti Boçi, të cilat janë çështje që kemi dakordësi.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Atëherë, shkurtimisht, duhet të gjejmë mënyrat se si të bashkëpunojmë. Në propozimin që ne kemi bërë, nëse ne do të shkonim në Elbasan dhe i bënim këto takime, në takimin e parë me zgjedhësit vendorë, grupi që do të shkonte atje, tre nga opozita dhe tre nga mazhoranca, do të bisedonim me 37 njerëz, 7 kryetarë bashkish, 14 deputetë (deputetët e mazhorancës dhe të opozitës të 14 të Elbasanit), kryetarin e këshillit të qarkut dhe kryetarët e grupeve të këshillave bashkiakë, sepse unë besoj që kryetari i grupit të këshillit të bashkiak socialist në Librazhd dhe ai i grupit demokrat në Librazhd janë përfaqësues të mirë të shqetësimit të Librazhdit, siç besoj se ai i Përrenjasit është një përfaqësues i mirë i shqetësimeve të asaj zone. Duke i mbledhur të gjithë këta njerëz bashkë në një dhomë, do të kishim mundësi të bënim një diskutim të mirëqenë për problemet që ka kjo zonë, por që do të flisnim me 37 veta. Në takimin e dytë me stafet teknike, do të kishim 40-50 veta, midis tyre do të ishin nënkryetarë, sekretarë të Përgjithshëm, drejtorë, drejtorë agjencish varësie nga secila prej bashkive dhe do të kishim mundësi të merrnim inpute nga shumë pika.

Në takimin e fundit të hapur me publikun, do të kishim 150 veta ndoshta, që mund të bënim një diskutim të hapur me një grup më të madh njerëzish. Kjo do të na mundësonte që të lëviznin gjashtë anëtarë komisioni, tre nga mazhoranca, tre nga opozita, dhe në një ditë të takonim rreth 250 veta, të merrnim opinion dhe të diskutonim me 200 njerëz. Inversi që të ngremë 200 njerëz dhe t'i sjellim këtu, më duket pak jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bardh Spahia – Për dëgjesa publike përcaktohet qartësisht se kush është marrë. Po e them edhe një herë, bashkitë organizojnë shpesh dëgjesa publike, të paktën bashkia Shkodër ka qenë në vend të parë për organizimin e dëgjesave publike, dhe përcaktohet

qartë se çfarë është dëgjese publike, ndërsa ajo që thoni ju, është dëgjese me ekspertë; mund të jetë dëgjese me përfaqësues apo një komunikim i ndërsjellë ndër-institucional, por nuk është dëgjese publike. Dëgjesa publike është dëgjese me dyer të hapura për publikun, ku mund të përfshihen edhe ekspertë të fushës, që do të ishte shumë më mirë të kishte prezencë të tyre, por dëgjese publike është dëgjese me dyer të hapura. Ai që ju thoni, është një komunikim ndër-institucional normal, ose një komunikim me ekspertë të fushës.

Arbjan Mazniku – Për përkufizim termash mund të diskutojmë gjerë e gjatë; se çfarë është dëgjesa publike, është një debat që mund ta bëjmë, por, përveç termit, unë mendoj, pa hyrë në terminologji, që këtij komisioni i duhet shumë që ne të shkojmë një ditë në Shkodër dhe të takojmë të gjithë kryetarët e bashkive, të gjithë kryetarët e grupeve të këshilltarëve bashkiakë si socialistë, si demokratë, të jenë atje dhe të dëgjojmë për problemet që kanë edhe Shkodra, edhe Vau Dejës, edhe Malësia e Madhe, edhe Fushë-Arrëzi, edhe Puka. Unë mendoj që ne duhet të dëgjojmë edhe problemet që kanë deputetët përfaqësues, në zonat ku janë zgjedhur, qofshin këta të PS-së apo të PD-së, dhe të na thonë se si e mendojnë ata funksionimin e përditshmërisë së pushtetit vendor. Unë besoj se ky diskutim është diskutim i dobishëm të ndodhë një ditë të tërë në Shkodër. Pastaj, a duhet që në një ditë të caktuar të dëgjojmë edhe një komunitet të caktuar që na ka shkruar, unë nuk jam kundër asaj, s'kam thënë kurrë jo, por si fillim unë besoj se duhet t'i dëgjojmë problemet e Fushë-Arrëzit nga kryetari i Fushë-Arrëzit, kryetari i grupit të këshilltarëve socialistë dhe kryetari i grupit demokrat në këshillin bashkiak; gjasat janë që ata njerëz do të na i thonë me ndershmëri dhe me drejtësi se si i mendojnë ata problemet e tyre. Sigurisht që në një moment të caktuar duhet t'i pyesim edhe qytetarët, por të fillojmë me këta, të cilët qytetarët e qytetit të tyre i kanë zgjedhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me këtë mekanizmin që t'i sjellim ata këtu, kërkohet që të lëvizim 60 veta të vijmë këtu, në vend që të lëvizim gjashtë nga ne dhe të shkojmë atje.

Zoti Dule.

Vangjel Dule – Së pari, do t'u lutesha bashkëkryetarëve të shmangin mënyrën kaotike të debatit dhe diskutimit. Dua ta mbështes plotësisht propozimin e zotit Boçi, sepse është një propozim që ka përmbajtje. Çfarë na duhet?! Supozohet se nesër shkojmë në Berat, ose duhet të ishim sot, çfarë duhet të bënim, të dëgjonim 37 veta? Por po jua them unë mendimin: 32 janë me qëndrimin tuaj, 5 janë me qëndrimin tonë, mbaroi muhabeti dhe e ezauroam ciklin. Ky është qëllimi?! Ajo që besoj se na duhet,

nëse duam të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin dhe me misionin që kemi marrë përsipër, është ta nisim nga burimi. Ne nuk do të shpikim rrotën, është një procedurë që ka ndodhur, pra të premtën në mëngjes a mund t'i kërkojmë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor (t'i japim një seancë prej 4, 5, 6 apo 7 orësh, sa ta dojë), që të na detajojë nga këndvështrimi i qeverisë se cilat kanë qenë rezultatet e reformës territoriale-administrative të vitit 2014, pozitivet apo negativet? E para.

E dyta, le të kontaktojmë kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, të cilët janë të zgjedhur, sepse prefektët nuk besoj se na hyjnë në punë në këtë diskutim. Kush është gati të vijë për audiencat e para, 1, 2 apo 22 orëshe? Ne këtu, jemi në dispozicion.

Po të shkojmë në Shkodër, kemi 12 orë, ndërsa këtu kemi 120 orë, ku mund të jemi në vazhdimësi dhe mund t'ju dëgjojmë të gjithëve radhazi. Për mua, në këtë epokë digjitale dhe me këtë qeveri që na ka superdigjitalizuar, është e rëndësishme të dimë se kur do të hapim një platformë, ku t'u bëjmë me dije që ne, si komision transparent, jemi të hapur të dëgjojmë çdo ish-kryetar, çdo ish-këshilltar, çdo OJF që merret me pushtetin vendor apo çdo organizëm që përfaqëson diçka dhe dikë, në mënyrë që të vijnë dhe të na paraqesin mendimet apo këndvështrimet e tyre për ndarjen territoriale-administrative në përgjithësi apo për zona të veçanta në veçanti. Pasi t'i kemi ezauruar këto faza, nuk do të na duhet të shkojmë në çdo bashki, por në ato bashki që janë problematike.

Për shembull, po të shkosh në Bashkinë e Roskovecit (nuk qëndron, se nuk ka probleme) mund t'ju thonë: ne nuk kemi asnjë problem, jemi të kënaqur me reformën territoriale-administrative. Nuk është e nevojshme të shkojmë për të dëgjuar lavdet, por në krah mund të ketë një bashki që ka probleme, dhe ne duhet të jemi aty.

Më lejoni të ndaj me ju konceptin e dëgjesave publike. Zoti Bardhi ka të drejtë që insiston, pra neve na intereson mendimi i komunitetit. I cilit komunitet? I atij komuniteti që është prekur nga reforma territoriale-administrative e vitit 2014.

E bëjmë në Vlorë. Po ju marr një shembull: një qytetari të njësisë administrative të Theollogos, në Bashkinë e Finiqit, për të ardhur në Vlorë, për të shprehur mendimin e atyre banorëve, do t'i duhen 7 orë. A do të vijë? Nuk do të vijë, sepse nuk do t'i bie rasti as të diskutojë, as të shprehë mendimet, as ta dëgjojë njeri, ose mendimi i tij do të humbasë midis mendimeve të 150 njerëzve të tjerë.

Nëse një grup yni prej tre vetash (në mos të gjithë) do të shkojë dhe do t'i shohë në terren, do t'i konstatojë dhe do t'i prekë pasojat e reformës territoriale-

administrative. Prandaj, le të jemi pak më krijues në konceptin e dëgjesave dhe të përthithjes së mendimit të komunitetit.

Të nderuar bashkëkryetarë, është e papranueshme të operojmë pa specialistë, është dhuratë e padhuruar dhe, meqë u fol dhe u stërfol për një platformë koordinimi dhe organizimi, kjo është elementare. Siç jua thashë, insisto, ta hapim dhe ta bëjmë publike, në mënyrë që, kujtdo që do të paraqitet në komisionin tonë me një kohë të kufizuar, të cilën do ta përcaktojmë të gjithë së bashku, t'i krijohet mundësia për një dëgjesë, në qoftë se përfaqëson diçka apo dikë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Kam vetëm diçka për t'ju thënë, dhe do ta them sinqerisht. Nuk mendoj se, nëse do të shkoni në Berat nesër, meqë u mor si shembull, apo në Vlorë dhe do të takonim njerëzit që u përmendën në listë, do të merrnin një mendim politik të një krahu dhe një të krahut tjetër, sepse unë mendoj se në këtë fazë duhet të shkojmë dhe t'i pyesim njerëzit se si ka funksionuar çështja e financave vendore. Nëse do t'u bëjmë këtë pyetje, gjasat janë se nuk do të ketë një diskutim që do të vijë me kah politik. Nëse ne i pyesim se si kanë funksionuar çështja e lejeve të ndërtimit për shtëpitë në fshat, çështja e ndihmës ekonomike apo e shërbimeve të tjera sociale, nëse ne e kemi nisur si proces, duke filluar nga funksionet dhe kompetencat që kanë bashkitë, dhe nëse do të shkojmë për të bërë një diskutim të sinqertë me njerëzit, për t'ua zgjidhur këtë hall që e kanë përditë në kurriz, duke i pyetur se çfarë problemi kanë për këtë funksion, nëse e bëjnë apo nuk e bëjnë dot, çfarë ka funksionuar e çfarë jo, gjasat janë se nuk do të ngecim në hulli politike, ku 32 do të mendojnë në një mënyrë dhe 7 në mënyrë tjetër, por do të bëhet një diskutim i mirëfilltë, që edhe anëtarët e nderuar të këtij komisioni të kenë mundësi të thonë se këto çështje duhen zgjidhur në këtë mënyrë. Nëse do ta zbresim këtë çështje direkt, siç shtyhet në një çështje harte territori, do të mbesim në hulli politike, ose partizanë, se politikë do të jemi gjithmonë. Unë mendoj se ka një debat dhe kemi një oportunitet për të bërë një diskutim me qytetarët, me të zgjedhurit vendorë, për funksionet, për kompetencat që kanë bashkitë, për mekanizmat dhe mënyrat që ata kanë për t'i zbatuar siç duhet ose jo këto kompetenca. Logjikën që të shkojmë atje, e kemi propozuar që në agjendën e mëparshme, pra që në dokumentin që kemi miratuar ishte propozuar ky mekanizëm, për të lehtësuar mbledhjen e opinioneve paralelisht në të gjithë territorin. Nëse ju mendoni ta bëjmë maratonë këtu, e shohim edhe atë si option, nuk ka asnjë problem. E para.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një moment, sa ta mbaroj fjalën.

E dyta, ne duhet të ndajmë dy gjëra, të cilat besoj se janë shumë të arsyeshme dhe nuk ka ndonjë arsye pse të mos i ndajmë. Secili prej nesh, si anëtarë të komisionit apo grupe anëtarësh të komisionit, duhet të jetë i lirë të takojë cilindo grup që mendon se përfaqëson. Takimet që bëjnë anëtarët e komisionit për këtë çështje, janë një gjë, dhe takimet e ftesat formale të komisionit janë një gjë tjetër. Pra, kur ka grupe interesi, që duan të takojnë dy apo tre veta, dikush nga qarku i tij, dikush nga një qark tjetër, në këtë pikë nuk është e nevojshme që çdo grup, nga ndonjë fshat apo qytezë, të dëgjohej nga i gjithë komisioni; mund të dëgjohej nga deputetët që vijnë nga ai qark apo nga grupi që mbulon atë territor dhe ta paraqesin atë shqetësim më pas në komision. Thelbi i çështjes është: nëse duam të dëgjojmë maksimumin e mundshëm të njerëzve, kjo gjë nuk bëhet dot këtu, sepse, në numra operacionalë, mundësia për t'i thirrur njerëzit këtu... Do të thërrasim kryetarët e bashkive, po ashtu, disa këshilltarë, dhe ne këtu jemi 16 veta, ndërkohë, në qoftë se do të ndaheshim në tri apo katër grupe, mund t'i dëgjonim paralelisht dhe më pas të rikthenim këtu opinionin e më shumë njerëzve. Logjika këtu vjen komplet nga e kundërta. Unë kërkoj të dëgjojmë më shumë njerëz, jo më pak. Ky ka qenë sugjerimi dhe logjika.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Një minutë, zonja Bylykbashi.

Meqë po ecim në vazhden e debatit që po bëjmë bashkë dhe në bazë të atyre që u diskutuan, sepse kemi ngecur te kjo pjesë, nëse do ta bëjmë dëgjuesën në vendin e caktuar apo do ta bëjmë këtu, dhe ku është efektiviteti më i madh, nëse takojmë më shumë apo më pak njerëz, sepse edhe kjo ana numerike ndonjëherë të ngatërron, të takosh shumë njerëz, nuk do të thotë të jesh më efektiv, mund të jesh edhe më shumë kaotik.

Çështja është se këto katër takime brenda një dite, kur i thua virtualisht duken bukur, por fizikisht, siç u tha edhe këtu, nuk e kemi kohën në dispozicion për të bërë katër takime brenda një dite, sepse, minimalisht, një takim me 35 veta zgjat mbi 2 orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbi 2 orë, sepse po thua se do të dëgjojmë 35 veta, se nuk do të flasim nga 5 minuta ata; të bëhemi të logjikshëm. Mundësia për të qenë efektivë është këtu, ku kohën e kemi pa kufizim, se e kemi marrë përsipër këtë detyrë, dhe ai që flet mund të shtrojë

argumente mbi 5 minuta, se në 5 minuta nuk përmbledh asgjë, dhe kjo është logjikë kohore.

Ne mendojmë, edhe unë personalisht (jo se kemi të njëjtin mendim dhe komandon dikush, por dalin si mendime), se jemi më efektivë t'i zhvillojmë këtu dëgjesat, t'i hapim që ditën e premte, jo vetëm mbi bazën e detyrimit, por edhe mbi bazën e dëshirës, sepse edhe kjo është shumë e mirë. Ka njerëz që duan të japin mendime, janë personalitete, që ndoshta na shpëtojnë në ato thirrjet zyrtare të organizimeve tona. Patjetër që është edhe paragjykimi, që, në një ambient ku 32 veta vijjnë nga një përfaqësim politik i caktuar, kanë të njëjtin mendim, dhe pjesa që mbetet (7 apo 10, nuk ka rëndësi) kanë mendim tjetër. Sesi funksionojnë mendimet e tyre, ne pak a shumë e dimë, bëjmë sikur s'e dimë dhe do të zbulojmë diçka të re ose: presim, mundet. Po si "mundet", kur ne e dimë shumë mirë se si do t'i parashtrojnë dhe çfarë do të thonë? Ndoshta këtu njerëzit janë edhe më të lirë, në dispozicion edhe të kohës që kanë; mund të vijjnë edhe njerëz të tjerë, përtej përcaktimeve politike. Mendoj të mos hyjmë më tepër në debate, duke i dhënë të drejtën gjithsecilit të thotë argumentet e veta, sigurisht, se nuk po kërkoj mbylljen e mbledhjes, por duhet gjetur një dakordësi në këtë pikë.

Përderisa ne shprehim vullnetin që të ecim shpejt me dëgjesat, dhe paralelisht kemi dëgjesa publike edhe me komunitetet, kjo tregon qartazi se ne kemi një vullnet tepër pozitiv për të avancuar me punën e këtij komisioni. Mendimet e atyre njerëzve që e kanë përsipër këtë punë, ne do t'i marrim edhe këtu, edhe atje, në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë, madje këtu të argumentuara më shumë, sepse mund t'u bëjmë pyetje edhe më detajuese, të cilat atje, me 35 veta, nuk i bëjmë dot.

Unë jam anëtar i komisionit dhe po e përsëris: pse të mos i dëgjoj të gjitha shqetësimet e qarqeve të ndryshme dhe pse të marr pjesë vetëm në 3 qarqe të Veriut, për shembull, sepse edhe unë dua një mendim të formësuar? Në Veri mund të ketë një mendim tjetër, dhe duhet të ketë, sepse shpopullimi atje është më i madh; në Jug ka një mendim tjetër, sepse numri i bashkive është më i madh sesa në Veri, sikurse në qendër ndryshon. Unë do të formësoj qëndrimin tim, që të bindem edhe unë, pra nuk mund ta kemi të parcelizuar dhe në fund fare ta bëjmë: një dhe një, plus një tjetër, bëjnë tre. Jo, ne kemi qëndrimet tona dhe duam t'i shprehim edhe në bazë të informacioneve që sjellin ekspertët, nga dëgjesat, por edhe nga njerëzit që i kanë këto funksione, sigurisht, edhe nga publiku.

Fjala për zonjën Bylykbashi.

Aulona Bylykbashi – Faleminderit!

Para së gjithash, në mbledhjet e mëparshme dhe në këtë mbledhje ne vazhdojmë të diskutojmë kohën dhe cilësinë e reformës. Pa dyshim, objektivi ynë i përbashkët dhe kryesor është një reformë me cilësi. Shprehja “Koha është flori” është po aq e vjetër sa historia, kështu që përdorimi i kohës me eficiencë dhe për të arritur rezultatet e duhura, pa dyshim, duke pasur si objektiv qendror cilësinë e reformës, gjithashtu, është një objektivi i rëndësishëm.

Po vazhdojmë t’u rikthehemi disa diskutimeve. Pa dyshim, në mënyrë të përbashkët, ne kemi bërë miratimin e një plani pune, duke vendosur edhe mundësinë që të mund të rishikoheshin etapat dhe fazat, por në këtë plan pune kemi përcaktuar se do të ketë dy dëgjesa, pra dy ture dëgjesash, si dhe një pyetësor. Qysh në mbledhjet e mëparshme kemi folur dhe kemi përcaktuar që, në fazën e parë të dëgjesave, pa u kufizuar apo pa i kufizuar palët që do t’i dëgjonim në një format apo një draft të përpunuar prej nesh, të kishim mundësinë të merrnim opinionet e tyre për të arritur, paralelisht, së bashku me punën e ekspertëve, që do të bazoheshin në të dhëna konkrete të mbledhura dhe të analizuar prej nesh në përfundim, të merrnim edhe një opinion për rezultatet pozitive apo negative të fazës së parë të reformës së vitit 2014. Në këtë këndvështrim, besoj se është shumë e qartë se turi i parë i dëgjesave të përcaktuara është pikërisht për këtë qëllim, që ne të kemi mundësi të dëgjojmë aktorët e ndryshëm dhe qytetarët, sesi e kanë përjetuar ata dhe cili është opinionet e tyre për rezultatet e reformës së parë, të miratuar dhe të zbatuar tashmë.

Atëherë, cilët janë aktorët në agjendën e paraqitur nga ana jonë, nga grup-takimet e propozuara? Aktorët e parë janë kryetarët e bashkive, deputetët, kryetarët e këshillit të qarkut, prefektët dhe kryetarët e grupeve të këshillave bashkiakë. Nëse ne do ta shohim këtë kombinim, është shumë qartë se janë aktorët kryesorë, të cilët, mbi bazën e punës së kryer prej tyre gjatë gjithë këtyre viteve, mund të na japin një opinion se cilat kanë qenë rezultatet e kësaj reforme. Nuk shoh që në këtë përbërje ne të kemi kryesisht një qasje të mazhorancës, sepse në këtë përbërje, pa dyshim, deputetët janë edhe të pozitës, edhe të opozitës, dhe kryetarët e grupeve janë përfaqësues edhe të pozitës, edhe të opozitës, por, mbi të gjitha, janë qytetarë.

Nëse ne do të shmangnim kryerjen e këtyre dëgjesave nëpër territoret përkatëse, sigurisht, do të shmangnim një nga takimet më të rëndësishme për një nga kolonat e miratuara nga të gjithë bashkë të kësaj reforme, që është ajo e funksioneve.

Kush mund të na flasë sot për funksionet më shumë sesa ata që janë specialistë, që e kanë prekur në vazhdimësi të gjithë reformën territoriale të miratuar deri tani, që janë: drejtorët, sekretarët e përgjithshëm, drejtorët e agjencive, pra janë njerëzit që e prekin pushtetin vendor çdo ditë dhe çdo orë të punës së tyre?

Pa dyshim, unë këtu ndaj një ide të ndryshme nga kolegët opozitarë, sepse mendoj se administrata publike sot përbëhet nga specialistë të mirëfilltë, që e kryejnë me përgjegjësi punën e tyre.

Kjo, pa dyshim, ha një debat të gjatë, por nuk do t'i hyjmë kësaj, që bazat ligjore të miratuara ndër vite kanë sjellë këtë. Ne nuk mund të flasim këtu për një administratë që i përket vetëm mazhorancës apo një administratë në të cilën përjashtohet opozita. Unë vij nga një eksperiencë shumëvjeçare në administratë, aty kam punuar masivisht me kolegë që u përkisnin krahëve të ndryshëm politikë, që i bashkonte teknikisht puna.

Kështu që, mendoj se është shumë e rëndësishme që ne ta dëgjojmë opinionin i këtyre njerëzve, të cilët e prekin çdo ditë ligjin e pushtetit vendor, ligjin e financave.

Në anën tjetër, kemi dëgjesat publike, ato që janë më të rëndësishmet. Ne nuk kemi pse të ndahemi, ku një ditë të shpenzojmë një kohë maratonë këtu me një grup të ngushtë njerëzish, ndërkohë që do të na duhet pastaj të shkojmë në territor një ditë tjetër dhe të kemi një dëgjesë me aktorët dhe grupet e interesit, por edhe qytetarët e përfshirë në këtë gjë. Mendoj se, sado masive t'i bëjmë ne këto dëgjesat publike në territor, që, pa dyshim, janë shumë të rëndësishme dhe themelore, sado qytetarë të ftojme në këto dëgjesa, asnjëherë nuk do ta kemi një opinion të përgjithshëm të qytetarëve në një dëgjesë, ku maksimalisht do të marrin pjesë po themi 200 apo 300 veta, që është një moment i pamundur për të komunikuar me 300 veta, dhe ne të gjithë e dimë këtë, pasi nuk është një takim elektoral, është një takim për të marrë një opinion. Për këtë qëllim, për të marrë në mënyrë të përcaktuar dhe të konsiderueshme opinionin e qytetarëve, në planin e punës është vendosur edhe një pyetësor për një fazë të mëvonshme, me të cilin është më e thjeshtë të marrim një opinion të qytetarëve.

Prandaj, unë propozoj që këto dëgjesa, për eficiencë kohe, të organizohen brenda një dite në territor, ku ne të shkojmë atje ku ndodhen të gjithë aktorët, sesa t'i ndajmë.

Mendoj se transparenca publike sot që flasim nuk është problem. Sot të gjithë njerëzit, ashtu siç ju kanë shkruar ju, më kanë shkruar edhe mua, por besoj edhe kolegëve të mi, kanë mjete publike, zyrtare për të komunikuar me ne. Gjithsecili prej nesh ka një postë elektronike, që është zyrtare për qytetarët dhe për të gjitha grupet e

interesit; ka një adresë postare në Kuvend, ku mund të drejtohen të gjitha opinionet; ka rrjete sociale, por mund të pasqyrohet lehtësisht dhe nga media, edhe nga profilet tona, nga faqja e Kuvendit, e kështu me radhë. Pra, nuk mendoj se këto takime nuk do të jenë të mbyllura.

Ndërkohë, për sa i përket argumentit që këto takime të organizohen nga partnerët, pa dyshim, partnerët për ne kanë qenë gjithmonë të mirëpritur dhe bashkërrugëtarë të të gjitha reformave tona, por mendoj se ky takim është për çështje logjistike. Njoftimi për në dëgjese do të jetë publik, që nuk do t'i mohohet pjesëmarrja askujt nga palët, ndërkohë që për çështje logjistike, besoj se i kemi të gjitha kapacitetet, sepse edhe kur kemi bashkëpunuar me partnerët publikë, në fund fare unë kam kuptuar që sallat, ambientet janë po ato që disponojnë pushtet vendore, si: teatri apo qendrat rinore. Gjithmonë takimet publike të çdo natyre, madje dhe vetë të opozitës, janë organizuar në këto vende dhe nuk mendoj se përbën diçka që do ta kufizonte apo mbyllte pjesëmarrjen e të gjitha opinioneve nga të gjitha palët.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Atëherë, të mos harrojmë diçka, sepse po shmanget nga ana procedurale, që fillimi dëgjesave duhet të paraprihet me atë që unë e kërkoja që në fillim, të zyrtarizohen ekspertët, të cilët nuk janë zyrtarizuar. Dëgjesat praktikisht nuk mund të nisin pa pasur një analizë, një raport vlerësues për reformën 2015-2025, sepse duhet të kemi një raport, dhe këtë e bëjnë vetëm ekspertët. Ndërkohë, në fjalën tonë ne nuk kemi refuzuar apo mohuar dëgjesat me kryetarët e bashkive, në mënyrë absolute. Ne po flasim për vendin dhe modalitetin e zhvillimit të dëgjesës, por jo për përjashtimin e tyre, të atyre njerëzve që e kanë përjetuar reformën. Nuk është se kryetarët e bashkive apo anëtarët e këshillit bashkiak posedojnë të vërtetën, sepse përndryshe nuk na duhesh ne ekspertë, por ndërtonim një grup mbështetës, me kryetarë bashkish dhe anëtarë të këshillave bashkiakë, dhe kryhej reforma, por ne na duhet mendimi i ekspertëve. Mendimi apo opinioni i tyre është opsional, shumë opsional, pavarësisht si mund të jetë në shumicë.

Për modalitetin nuk kemi dakordësi, unë e shoh, është normale, por unë po ndërtoj logjikën e kohës, në një sallë me 30 veta, të cilët do t'i dëgjojmë me nga 10 minuta, shkon në 300 minuta një takim, por 300 minuta bëjnë 5 orë, ndërkohë ne do të bëjmë 4 takime me 30 veta. Po sa orë efektive ka një ditë, sepse duhet edhe efektiviteti kohor?!

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk është te vendi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, ne do të bëjmë një takim ne me 30 veta dhe do të flasim 5 veta, se ne me 5 veta do ta bëjmë takimin realisht, se 30 veta nuk do të flasim ata, sepse ka edhe njerëz që flasim edhe gjysmë ore. Edhe ne vetë na kap ritmi dhe nuk e matim kohën. Pra, ne po bëjmë kërkesë në bazën e një logjike, për të rritur efektivitetin, nuk po bëjmë të kundërtën. Pra, ne po kërkojmë këtë lloj dakordësie, që të nisim menjëherë edhe me ekspertët. Pra, e thashë, duhet të na sjellin edhe raportin, sepse duhet edhe ky raport. Besoj se situata është e qetë, dhe të gjemë mënyrën për t'i thërritur. Është më e thjeshtë, më e dëshirueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e bukur ishte kjo e Maznikut, një herë kam folur, por treshin ose katrën e bëjmë 1, tani, ka ndryshuar edhe metodika e leximit të numrave, merre me mend metodikat e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Likaj.

Ramadan Likaj - Unë mendoj se propozimet tona u bënë të qarta. Po marr shkas nga kolegët e mazhorancës, sepse kanë shumë dëshirë për dëgjesat publike, për të marrë të gjithë opinionin, dhe për këtë edhe ne biem dakord. Atëherë, nëse ju nuk bini dakord me këtë propozim, për të cilin mendoj se kemi pasur dakordësi në mbledhjen tjetër, kur thamë që do të thërrasim kryetarë bashkish, por edhe ish- kryetarë bashkish, dhe u dakordësuam në këtë pikë, besoj. Në rastin konkret, nëse ne kërkojmë që të hapim sa më shumë diskutime, atëherë po unë bëj një propozim të ri, që është shumë më me vlerë për të gjitha bashkitë, ejani të shkojmë dhe të bëjmë dëgjesa në të 61 bashkitë sot dhe të shohim se cilat janë problematikat. Ky është propozimi real, nëse ju e keni këtë dëshirë. Pastaj, realisht ne do t'u prodhojmë shqiptarëve një reformë territoriale më jetëgjatë. Pse e them këtë? E them këtë që sot, pas 10-11 vjetëve, po kthehemi aty ku ishim, në vitin 2014.

Atëherë, ku janë problematikat? Janë në 12 qarqe, apo janë në 61 bashki? Kjo është pyetja. Nëse dikush nga ju mund të më japë përgjigje për këtë, unë gjej dakordësi. Ndaj, pas të gjitha diskutimeve që bëmë, ne ramë dakord që kjo është gjëja më e mirë: të thërrasim kryetarët e bashkive, por dhe ish- kryetarët e bashkive. Pastaj, në 12 qarqe ne të bëjmë një dëgjesë publike, pa kufizim, ku të përcaktojmë edhe kohën, siç e thanë dhe dy bashkëkryetarët, se sa do të flasim, jo pafund, sepse aty mund të vijnë edhe 150

vetë dhe mund të gjithë të duan të flasin me nga 10 minuta, pra duhet të përcaktojmë edhe kohën e folësve. Kjo gjë mund të prodhojë atë që kërkojnë realisht shqiptarët. Çdo veprim tjetër na çon në mënyrë të njëanshme, nuk na çon te realitetit. Ndaj, propozimi që ne ofruam si opozitë mendoj se i vlen këtij komisioni. Në të kundërt, bëni propozimin tjetër, që të bëjmë dëgjesa me 61 bashkitë e vendit dhe të marrim problematikat reale.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku - Zoti Bozdo.

Enno Bozdo – Dua të sqaroj pse kjo që propozojmë është ekzaktësisht për t'i lejuar komisionit fleksibilitet më të madh, ditë pune më shumë, por edhe mundësi për anëtarët e komisionit që duan të ndjekin jo thjesht dy qarqe, por më shumë se kaq. Kjo besoj është e ndershme.

Së pari, po flas për agjendën që kemi këtu.

Pjesës më të rëndësishme, që është konsultimi publik, ju i keni vendosur 1 orë e gjysmë. Nuk ka mbledhje për konsultim publik, ku do të jetë salla me 50 apo 60 veta, që shkon për 1 orë e gjysmë. Kjo nuk mund të ndodhë. Të gjithë e dimë që është e pamundur të menaxhohet koha, se nuk menaxhohen dot njerëzit që marrin fjalën. Këto janë mbledhje dhe takime që shkojnë në 2 orë e gjysmë deri 3 orë.

Arbjan Mazniku - E bëjmë 3 orë.

Enno Bozdo – Pra, është e pamundur që e gjitha kjo të ezaurohet në një ditë të vetme.

Së dyti, propozimi që ne dhamë, që ne të fillojmë menjëherë, sipas propozimit të zotit Dule, është shumë mirë, sepse edhe vëmë komisionin në punë, por edhe përgatitim të gjitha takimet e mëpasshme.

Së treti, duke mos u zhvendosur nga Tirana për çdo mbledhje që duhet të bëjmë, i japim më shumë kohë vetes, pasi i thërrasim të gjithë njerëzit këtu dhe marrim të gjithë kohën e duhur për t'i pyetur ata siç duhet. Fakti që i thërrasim këtu, nuk do të thotë që skartojmë kategori, as kryetarët e bashkive, as specialistët. Ne kemi rënë dakord për këtë, ne ata do t'i thërrasim. Diskutimi bëhet nëse do të kemi mundësi t'i thërrasim këtu, apo të shkojmë atje. Ky është diskutimi. Duke qenë këtu, mund të përdorim edhe ditë pune më shumë, pasi kemi edhe ngarkesa të tjera.

Nuk po themi se është një mekanizëm që nuk është përdorur edhe në komisione të tjera. Të gjitha komisionet që janë ngritur, kanë pasur të drejtën të thërrasin njerëz për t'i dëgjuar ata; kaq, as më shumë, as më pak, dhe nuk hiqet dorë as nga konsultimi

publik, dëgjesa publike, sepse të paktën në çdo qark duhet të shkojmë një herë, por të marrim të gjithë pasditen, t'i lëmë njerëzit të flasin. Kështu i kemi realizuar të dyja, edhe pjesën teknike, me njerëzit që janë në pozicione, kanë qenë në pozicione, njerëzit që i kanë futur duart në punë, njerëzit që njohin pjesën financiare e të tjera, duke marrë të gjithë kohën për t'u sqaruar, por edhe konsultimi publik, që t'i dëgjojmë nga afër ata.

Është gjëja më e mirë për të ecur përpara dhe për ta shpejtuar punë. Mos kujtoni se është propozim për të ngecur, jo, po të jetë për të ngecur, jua them unë, unë këtë e kam marrë vetëm sot, kam ardhur në këtë mbledhje vetëm se më është kërkuar të vij në këtë mbledhje, dhe më është kërkuar 3 orë para mbledhjes, dhe ja ku jemi. Ndryshe do të thosha që do ta mendoj. Prandaj është një mënyrë shumë e mirë për të ecur përpara, për të filluar punë që të premtën mundësisht.

Arbjan Mazniku - Zoti Jahaj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Klevis Jahaj - Aulona, një saktësim, se kemi qenë të gjithë këtu kur në mbledhjen e fundit miratuam kalendarin e punimeve, ku ishin specifikuar edhe modalitetet e takimeve që do të kryhen në agjendë, aty parashikuam që kur do të ishin: në javën e parë të marsit, në javën e dytë, në javën e tretë, ndërkohë kjo agjenda ka bërë vetëm zbërthimin në data specifike të kësaj. Nuk i kemi diskutuar këto çështje. Ne në mbledhjen e parë diskutuam që takimet do të ishin me kryetarët e bashkive...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Më dëgjo pak, se nuk të ndërpreva.

Tani, unë mendoj, për efekt diskutimi, se është më efektive sesa të kemi 61 kryetarë bashkish këtu dhe të mos u japim mundësi të flasin...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

...sesa ne të sjellim këtu stafet teknike të tyre. Normalisht, duke shkuar atje, bëjmë edhe atë që kishte merak bashkëkryetari, që të prezantohen ekspertët dhe t'u jepen mandatet, se nuk mund ta bëjmë këtu.

Nuk e kuptoj, pse të mos zhvillohen dëgjesat publike atje? Patjetër, edhe ne kemi kërkesa për të marrë pjesë në dëgjesa, të cilat i dërgohen sekretarit përkatës dhe ai i shton në takimet që mund të zhvillohen atje.

Edhe unë jam dakord për ndryshimin e agjendave, që të mos e bëjmë pushimin 2 orë e gjysmë, por ta bëjmë 1 orë, se nuk na duhet kaq shumë, në mënyrë që ta shfrytëzojmë për ndonjë takim tjetër. Pra, shmangia për të shkuar në terren, ku ne po mbledhim dhe po dëgjojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, se nuk të ndërpreva!

Jam dakord që ne të shkojmë të diskutojmë atje, të mandatojmë ekspertët, të mbledhim informacionin e duhur dhe të përfshijmë sa më shumë njerëz në këto takime, se nuk besoj se është më efektive, në lidhje me këtë proces, që të ftohen këtu një nga një.

Ne kemi rënë dakord për këto diskutime në takimin e parë, që të jenë kryetarët e bashkive, deputetët e opozitës dhe të pozitës.

Unë përfaqësoj krahinën e Mallakastrës, por, patjetër, kur të marr pjesë në takimin e Fierit do të shpreh opinionin që kam për votuesit e mi, pra nuk është e thënë të flasim të gjithë votuesit e krahinës, por edhe deputetët, siç mund të jenë edhe ata të PD-së, do të shprehin qëndrimet që kanë në lidhje me këtë proces, ndaj takimet bëhen edhe me përfaqësuesit politikë, të cilët janë mandatuar: kryetarët e bashkive, këshilltarë, që janë jo vetëm përfaqësues të Partisë Demokratike dhe të Partisë Socialiste, por edhe të forcave të tjera, komunitetet, minoritetet e kështu me radhë, prandaj bëhen takimet.

Në mënyrë që të shmangen masivitetet, se nuk janë mitingje, por janë dëgjesa me përfaqësues të caktuar, të cilët do të shprehin opinionin e tyre, ne mendojmë që, të shkosh pranë komunitetit, në nivel qarku, me grupe të caktuara deputetësh, me përfaqësues nga të dyja krahët e kësaj tavoline, është më efektive sesa t'i heqësh ata njerëz nga puna ditore dhe t'i sjellësh këtu. Ata janë në shërbim të komunitetit, dhe ne t'u themi: ejani këtu, se ne sot kemi mundësi t'ju dëgjojmë?!

Kjo agjendë është rakorduar bashkë me ministrin dhe me përfaqësuesit e pushtetit lokal. Nëse kemi propozime për data të caktuara, mund t'i bëjmë, mund të shohim mundësinë për t'i takuar pa i hequr ata nga puna dhe pa prishur agjendën e këtij komisioni.

Nuk e shoh të arsyeshme (se këtë diskutim e bëmë në mbledhjen e parë, pra që të shkojmë atje, e miratuar edhe në kalendar, edhe metodologjinë, edhe ekspertët, edhe mënyrën e punës) të vijmë këtu me një propozim tjetër dhe të themi: është më mirë të vijmë ata këtu, sepse është më ndryshe. Unë në këtë formë e shoh këtë propozim.

Më thoni, pse nuk është mirë që të përfshijmë të gjithë sekretarët dhe drejtorët e përgjithshëm të qarkut, që t'i dëgjojmë së bashku me ekspertët?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të jenë edhe këshilltarët tuaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe deputetët e PD-së...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe ti do të jesh në takim, ndaj jemi në rregull.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Tani, për sqarim, ne nuk kemi miratuar agjendë. Kjo agjendë ka ardhur para dy ditësh. Ne kemi miratuar një dokument gjeneral, për të cilin thamë se është shumë relativ dhe gjatë diskutimeve do ta modifikojmë sipas situatave që na paraqiten. Kjo ka qenë ajo që kemi diskutuar bashkë.

Nëse i referohesh këtij dokumenti, zotëri, duhet të konsiderosh se duhet të kishim analizën e periudhës 2015-2025, nëse do të jesh luajal dhe i ndershëm. Pra, duhet të ishin miratuar ekspertët, dhe këtë e thotë ky dokument që kemi miratuar, ndaj duhet lexuar i gjithi, jo vetëm pjesa e agjendës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, pra, që ana procedurale është shumë e rëndësishme! Duhet ta respektosh, meqenëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk dëgjohesh, se nuk ke mikrofon. Pastaj thua: pse më ndërpret?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne këtë po kërkojmë, që të biem dakord për atë çfarë paraqitet dhe aktualizohet. Ajo që kërkova unë është aktualizim, që ekspertët të zyrtarizohen, të sjellin informacionin dhe ne të vijojmë me dëgjesat, në bazë të një informacioni, të një analize josubjektive politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Se edhe ne bëjmë analiza, ju e dini shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, biem dakord për këtë pjesë.

Pjesa tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos e bëj pyetjen, se po e bëjmë debatin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk dëgjohesh, se nuk ke fokusin e kamerës.

Çështja tjetër: të mos e trajtojmë vajtjen në bashki si vajtje në terren, se nuk është e njëjta gjë të shkosh te zyrat e bashkisë.

Përfaqësuesit e bashkisë, edhe kur të vijmë këtu, do të punojmë për komunitetin, se ardhja këtu është punë për komunitetin, rezultative, sepse po diskutojmë çështjet e tyre, por ama, edhe ne për komunitetin punojmë, edhe kur bëjmë mbledhjet e tjera, se ju përdorni një gjuhë populiste, që duket sikur ne nuk duam të punojmë për komunitetin dhe po i heqim ata nga puna e po u themi: ejani të bëjmë pak muhabet në komisionin tonë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, ne po i kërkojmë takim për këtë gjë.

Fjalën e ka zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Të gjithë, si zakonisht, themi se nuk kemi kohë, por me kohën sillemi sikur e kemi të tepërt.

Mendoj se gjëja më e mirë në këtë rast është t'i japim një dozë realizmi situatës. Pa diskutim që këtu ka këndvështrime të ndryshme, dhe kjo është konfirmuar edhe nga fakti se nga ana jonë ka shumë vërejtje për sa i takon reformës së viteve 2014–2015, ndërsa ju thoni se ka qenë e shkëlqyer e të tjera. Pra, kjo diferencë opinionesh reflektohet edhe te qëllimi i reformës. Nëse do të ishte e shkëlqyer, sigurisht që nuk do të ishte aq e nevojshme, por këtë e kemi tejkaluar.

Që në mbledhjen e parë që kemi bërë, kam kërkuar të bëjmë një analizë, e cila do të ishte një ndihmë shumë e madhe për të kuptuar se çfarë do të bëjmë edhe në këto dëgjesa, që po i diskutojmë kaq gjatë sot. Nëse do të kemi parasysh problematikën, do të tregoheshim shumë më efikasë me kohën, me dëgjesat dhe me mënyrën se si do të arrijmë në një konkluzion racional, të pjekur dhe me qëllime të qarta. Sot që flasim, ende nuk e kemi të qartë. Ka disa materiale që ekzistojnë, dhe kjo është e vërtetë, por nuk kemi një konsensus për alternativat që do të diskutojmë në këto dëgjesa.

Jam dakord që dëgjesat të ndahen në dy grupe: e para të jetë me përfaqësuesit e zgjedhur, që mund të vijmë këtu, dhe jam plotësisht dakord me propozimin që u dha, dhe e dyta të jetë në vend. Por, para së gjithash, dua që të identifikojmë alternativat dhe opsionet se si do të hidhen për mendim te njerëzit që do të takojmë, se kam një lloj skepticizmi për efektivitetin e këtyre takimeve, nëse nuk arrijmë të kristalizojmë problematikën dhe ato që do të hedhin si alternativa për diskutim. Pa diskutim, nëse do të flitet në përgjithësi nga përfaqësuesit e ardhur, pa paragjykuar askënd, dhe për problematika që dalin jashtë asaj që duhet të peshojmë në këtë komision dhe të reflektojmë edhe në raport, mendoj se koha nuk do të jetë e përdorur në mënyrë efektive.

Mendoj se kjo është e domosdoshme dhe, nëse i vendosim prioritetet ashtu siç duhet, mendimi i njerëzve që do të takojmë ka shumë më tepër peshë sesa personat që janë të emëruar në administratë, sepse përsëri do t'i fusin një dozë realizmi, pasi e dimë se sa "realistë" janë ata, veçanërisht ata që janë në administratën e sotme të pushtetit vendor. E ritheksoj: është domosdoshmëri që, ndërsa ne përgatitemi për këto dëgjesa, të përshpejtohet puna me analizën dhe me problematikat, për të cilat duhet të miratojmë radhën prioritare dhe peshën që kanë. Nëse nuk e kemi këtë, kam përshtypjen se dëgjesat nuk do të jenë efikase dhe do të jenë të tejzgjatura.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Presupozimi ka qenë (thjesht për ta shpjeguar) se ne mund t'i bëjmë paralelisht të dyja ushtrimet, pra teksa komisioni dëgjon njerëzit që janë në listë, të cilët janë përfaqësues të publikut, grupi i ekspertëve, paralelisht, punon për këtë gjë dhe, për më shumë, përfshin edhe opinionet e mbledhura në dokumentin përfundimtar.

Edhe në dokumentin origjinal që na është prezantuar thuhet se, në fund të marsit, me mbarimin e dëgjesave (mund të shkojë edhe java e parë e prillit, se nuk e mbaj mend), bashkohej puna e ekspertëve nga ana empirike, duke parë raportet, të dhënat dhe informacionin, me opinionet dhe në fund analiza përbëhej nga dy elemente: elementi empirik, analitik i të dhënave, shifrave dhe raporteve, ndërsa elementi i dytë është opinionet e njerëzve që e kanë këtë punë përditë në detyrë. Pra, ecim paralelisht me të dyja ushtrimet. Nëse i vendosim njërin para dhe tjetrin mbrapa, përveçse do të humbasim kohë, do të kemi dy gjëra të ndryshme, se logjika ishte t'i vendosim paralelisht të dyja proceset.

E kuptoj që dikujt mund t'i duket sikur është shumë punë, por në propozimin e bërë nga ana jonë ishin 6 veta, 3 nga ne dhe 3 nga opozita, që do të kishin Veriun, të cilët do të zhvillonin takime më 13, 17, 18 dhe 24 mars, çka do të thotë se ky grup, teorikisht, do të bënte 4 takime, por edhe grupi i qendrës dhe grupi i Jugut kanë nga 4 takime. Në këtë mënyrë, komisioni dhe ekspertët kishin mundësi të preknin të gjithë territorin, pra të kishim dy inpute dhe t'i ndërlidhim të dyja burimet e informacionit.

Nëse ne do t'i thërrasim këtu, atëherë do të duhet të bëhen 12 takime, herë 4, pra 48 takime. Një proces që teorikisht mund të bëhet në 4 ditë pune, tani do të kërkojë minimalisht 48 ditë pune për të realizuar të njëjtin objektivi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është matematikë, nuk ndodh ndryshe.

Luçiano Boçi – E paskemi me normë, si para viteve '90, se kështu matej efektiviteti!

Ndërkohë, unë e argumentova që në ato takime nuk do të flasin të gjithë njerëzit, pra bie matematika jote, se do të flasin 5 veta gjithsej; është e njëjta kohë sikur ata 5 veta të vinin përpara këtij komisioni dhe të parashtronin idetë e tyre, sepse aq është mundësia fizike dhe koha në një takim të gjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos hyjmë në detaje, se nuk na shërben...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, pa dalë aty, sepse thatë që ekspertët punojnë paralelisht me dëgjesat. Ekspertët nuk e marrin informacionin nga dëgjesat, e marrin në rrugë të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është komplementare, edhe dëgjesat, por pa pasur një analizë nga ekspertët. Nga të dhënat që ata kanë marrë për rezultatet e reformës që është realizuar, 2015 – 2025, ne nuk kemi një bazë nisjeje të arsyeshme dhe argumentuese për të ndërtuar dëgjesat, sepse është një gjë që na duhet. Ju e kapërceni procedurën, ndërkohë që unë po them të respektojmë procedurën, të zyrtarizojmë ekspertët, t'u japim kohën e duhur që të sjellin ekspertizën e duhur, shumë shkurt, 1 apo 2 ditë, besoj se e kanë realizuar. Këtu po ndërtojmë atë pingpongun: ne kërkojmë dëgjesa me efektivitet real, duke i thirrur këtu, ndërsa ju mendoni se duhet të shkojmë në qarqet përkatëse, në qendrat e bashkive të qarqeve. Kjo ju duket efektive me staf teknik, por nuk është staf teknik, se u arsyetua, e dimë sesi janë emëruar dhe se çfarë qëndrimesh kanë, edhe *rigid-e*, politike, madje ndonjëherë edhe më të forta se vetë politikanët, këshilltarët apo drejtuesit, ndoshta të bashkive, të cilëve u intereson të kenë një qëndrim më fluid në raport, sepse kanë edhe votues të ngjyrave të ndryshme, dhe të bëjmë sikur po bëjmë dëgjesa.

Pa u zgjatur shumë në debate, sepse e di që do të ketë edhe debate të tjera, unë dua t'i bashkoj të dyja propozimet në një propozim të fundit, në kuptimin që të mos hyjmë në debate të shumta. Meqenëse ju dëshironi dëgjesa në nivel qarku, sigurisht edhe ne i duam; ato nuk janë dëgjesa publike, por le t'i bëjmë publike. Si t'i bëjmë publike? Mund të organizojmë dëgjesa publike në Elbasan ose në Shkodër, ku të pranishëm; ta bëjmë thirrjen publike, të jenë edhe kryetari e bashkisë, është këshilltarët, edhe stafet e tyre, po deshën, edhe qytetarë të ndryshëm. Po ashtu, duhet të përcaktojmë

kohën e debatit publik. Pra, të bëjmë 12 takime publike në qarqe, ku të jenë të pranishëm edhe kryetarët e bashkive, edhe qytetarët, edhe këshilltarët, dhe ta realizojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, është me thirrje publike.

Vetë komisioni duhet të ruajë diskrecionin që të thërrasë pranë tij çdo person që e gjykon si të domosdoshëm për të dhënë mendim në lidhje me reformën territoriale, që pretendohet të realizohet ose për rezultatet që ka pasur ajo reformë e mëparshme, dhe pastaj të ballafaqojmë qëndrimet. Pra, propozimi i gërsheton të dyja qëndrimet: edhe qëndrimin tuaj, edhe qëndrimin tonë. Do të jenë dëgjesa publike, jo me 30 vota, por shumë më të gjera, ku secili mund të japë mendimin e tij, me një zgjatje të kohës, por po themi nga katër takime, që mund të zgjasin 3 orë, 12 orë, dhe se bëjmë një takim 8 orë, kjo do të thotë që kemi kursyer kohë, kemi angazhuar shumë njerëz dhe kemi marrë mendimin e çdo qytetari, i cili, siç thanë edhe zoti Dule, edhe zoti Haxhinasto, është shumë herë më i vlefshëm ndonjëherë se vetë mendimi i atyre që sot paguhen për të dhënë mendimet e tyre.

Arbjan Mazniku – Përtej sofizmave, në dokumentin që kemi prezantuar ai është takimi i tretë, në të cilin kemi edhe njerëz të zgjedhur; ai që sipas agjendës është takimi i pasdrekes, dhe ka pikërisht këtë logjikë, ku kemi të zgjedhurit vendorë, ish- të zgjedhurit vendorë, dhe të hapur për publikun, ku mund të vijë kush të dojë. Por, nga ana tjetër, besoj se nuk mund ta trajtojmë me të njëjtën vëmendje komisionin e Parlamentit të Shqipërisë, i përbërë nga ne, deputetët, dhe kryetarin e bashkisë, të zgjedhur nga 40 mijë banorë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po duroni një sekondë, sepse unë ju dëgjova të gjithëve dhe nuk i fola asnjërit, ndërkohë sapo u përmend një kryetar bashkie, flisni të gjithë. Një sekondë, sepse unë ju dëgjova secilin me durim maksimal, nuk ndërpreva asnjërin, dhe ju kam dëgjuar me durim të jashtëzakonshëm.

Pra, po ju them se është detyra jonë të dëgjojmë të 61 kryetarët e bashkive. Nga ana tjetër, unë besoj se ne duhet të dëgjojmë edhe deputetët për këtë çështje. Pra, përveç nesh, si anëtarë të komisionit, kur ne të shkojmë të diskutojmë për Elbasanin, duhet të takojmë të gjithë deputetët e Elbasanit; kur ne të flasim për Vlorën, duhet të takojmë të

gjithë deputetët e Vlorës, për të diskutuar për mënyrën si funksionon qeverisja lokale e këtij qarku. Unë mendoj se duhet të dëgjojmë edhe këshilltarët e bashkive përkatëse.

Tani, hajde ta bëjmë këtë ushtrim në praktikë. Na u bë një propozim, që u tha se duhet të takohemi të premtën. Pyetja që kam unë është: hajdeni ta bëjmë të premtën, por cilin do të ftojme? Hajdeni ta bëjmë këtë në praktikë: më thoni, kë do të ftojme të premtën, në takimin e parë? Kush e bëri propozimin, le ta bëjmë tani ushtrimin dhe t'i vëmë përballë të dyja propozimet.

Vangjel Dule – Që ta kuptojmë njëri-tjetrin, nëse duam ta kuptojmë, sepse më duket se nuk duam ta kuptojmë njëri-tjetrin deri tani, kjo është përshtypja ime, sepse ne nuk i përjashtuam dëgjesat publike në asnjë moment. Madje, ishim të qartë: mund të realizohen të dyja, jo vetëm njëra, pra ne nuk thamë: ose njëra, ose tjetra.

Juve keni vënë Beratin sot, pra duhet të ishim në Berat. Një orë e gjysmë me kryetarin e bashkisë, deputetin, kryetarin e këshillit të qarkut, prefektin, kryetarët e grupeve të këshillave dhe bashkiakë: si jeni, si keni kaluar, si janë nga familja, dhe mbaron takimi. Unë nuk e di përse jeni këtu, por unë mund t'ju them përse jam unë këtu. E di që kryetari i Bashkisë së Beratit është shumë i suksesshëm, ndërsa ish-kryetari i bashkisë, që e keni bërë edhe ministër, është edhe më i suksesshëm. Unë kam për t'i drejtuar 3-4 pyetje edhe njërit, edhe tjetrit, që ta kuptoj suksesshmërinë e tyre dhe do ta çoj aty në bashkinë time të Vlorës, që po vuajnë pasojat e reformës së 2014-ës.

Pra, kur do ta kem këtë mundësi brenda një ore e gjysmë që keni ju, me këto personazhe dhe me 14 apo 16 deputetë të komisionit? A kemi të drejtë të gjithë të drejtojmë nga një, dy, apo tre pyetje?

Arbjan Mazniku – Jemi në rrugë të mbarë, zoti Dule...

Vangjel Dule – Më lini të mbaroj, të paktën...

Arbjan Mazniku – Jemi në rrugë të mbarë, hajdeni ta bëjmë këtë takim 3 orë, por skenari që t'i thërrasim këtu, është e sigurt që nuk funksionon për momentin.

Vangjel Dule – Më lejoni të mbaroj argumentin.

Arbjan Mazniku – Po, të lutem!

Vangjel Dule – Pra, me sa kuptoj, koncepti juaj është që të bëni një festë.

Arbjan Mazniku – Jo, nuk është kështu.

Vangjel Dule – Po më lejoni të mbaroj. Këto që po shkruani këtu janë vetëm festime, janë thjesht për festa, për t'i thurur lavde njeri-tjetrit dhe për të mbyllur

procesin. Nëse duam esencë, esenca bëhet këtu dhe nuk na pengon askush të shkojmë 1, 2, apo 22 herë edhe në Berat, edhe në Dibër, edhe kudo që të jetë nevoja, por...

Arbjan Mazniku – Nuk qëndron fjalia e parë me të dytën, sepse, ose do të bëhet dëgjesa këtu, ose do të shkojmë atje.

Vangjel Dule – Nuk i bëhet pyetja një deputeti për kryetarin e bashkisë, apo për prefektin, apo për dikë tjetër në prani të 150 vetave.

Arbjan Mazniku – Jo, nuk është ashtu, nuk janë 150 veta, sepse në takimin e parë nuk janë 150 veta. Në takimin e parë, kur të shkojmë në Berat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk kam asnjë problem që takimi i parë, mendoni që nuk do të zgjasë një orë, doni ta bëjmë dy orë e gjysmë, hajdeni ta bëjmë dy orë e gjysmë, por nuk janë 150 veta...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, vetë më thatë që duam publikun.

Vangjel Dule – Zoti bashkëkryetar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për takimin e parë, besoj se isha shumë i sigurtë, për mua është festë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, një sekondë, që ta bëjmë praktike: për mua: 10:00-11:30 me kryetarin e bashkisë, me deputetë, me kryetarin e këshillit të qarkut, është një festë.

E dyta, nuk është nevoja për nënkryetarin, sekretarin e Përgjithshëm, drejtorin e Përgjithshëm, i përfaqëson kryetari i bashkisë, ka mbaruar. Dreka nuk është e nevojshme fare, për mua mbetet e fundit. Kur të ketë shoqata biznesi, grupe të interesit, shoqëri civile e të tjera, ky është për mua thelbi, të tjerat janë fjalë sa për t'u gjendur në muhabet.

Arbjan Mazniku – Nuk është kështu.

Vangjel Dule – Dakord, ndajmë mendime të ndryshme. Do të ishim një parti, nëse do të ndanim të njëjtat mendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë, po nxitoheni!

Vini e na propozoni një procedurë që nuk është ndjekur ndonjëherë. Ka pasur një konsensus komisioni i viteve 2022-2023, pse nuk e ndjekim atë procedurë, që është ndjekur nga të gjitha komisionet?! Ju tani e merrni topin, në vend që ta luajmë lojën në fushën e futbollit, ju e hidhni në shkallët e stadiumit. Këtë doni të bëni?! Topi luhet në

fushë, jo në shkallët e stadiumit. Ju doni të na bënë lojë, patronazhistët do të na bëni tani?! Kjo është lojë patronazhistësh. Nuk jemi të predispozuar ta luajmë, të paktën me ndërgjegje dhe me sinqeritet.

Arbjan Mazniku – Ndjesë që të ndërpreva, se nuk e kam zakon!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk po kthej përgjigje, por dy gjëra duhen thënë.

Së pari, logjika që thuhet këtu që të shkojmë të takojmë publikun, njerëzit, unë jam 100% dakord që t'i takojmë dhe njerëzit. Nga ana tjetër, thuhet: jo, të mos t'i takojmë atje, por t'i takojmë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Vangjel Dule – Sa herë duhet ta them, se nuk them ose njëerën ose tjetrën, por them edhe njëerën, edhe tjetrën.

Arbjan Mazniku – Edhe njëerën, edhe tjetrën.

Vangjel Dule – Nuk e thashë në greqisht, në shqip e thashë.

Arbjan Mazniku – Thelbi është: këtë po themi edhe ne edhe njëerën, edhe tjetrën. Kemi thënë edhe takim me të zgjedhurit. Unë, ndryshe nga ju, mendoj se është shumë e dobishme që ky komision t'i dëgjojë njerëzit që merren me shërbimet sociale në bashki se çfarë problemesh kanë ata, përveç problemeve që ka kryetari; njerëzit që merren me financat çfarë problemesh ka ofrimi i atij shërbimi; ata që merren me strehimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Siç tha me të drejtë zoti Dule, mund të kemi mendime të ndryshme. Unë mendoj dhe besoj shumë fort se, nëse ne do të bëjmë realisht një reformë për mirëfunksionimin e pushtetit vendor, që është synimi ynë, patjetër që zëri i njerëzve, të cilët merren me ofrimin e shërbimit, duhet të dëgjohet, për të kuptuar se çfarë problemesh kanë pasur për të ofruar shërbimin. Duhet dëgjuar ata njerëz që kanë detyrë ta ofrojnë shërbimin përditë, përveç kryetarit. Kryetari i zgjedhur qoftë socialist, qoftë demokrat, është i zgjedhur politik. Duhet të pyetet ai njeriu që ofron shërbimin social se çfarë problemesh ka për ta ofruar shërbimin social; ai personi që merret me lejet e ndërtimit në fshat, çfarë problemi ka me ofrimin e shërbimit; ku ngec gjëja? Kjo logjika që nuk na duhet t'i dëgjojmë këta që merren me punën...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Romina Kuko – Bashkëkryetar, nga vetë fjalët “konsultim publik”, me sa dimë ne, por kam përshtypjen edhe ata që kanë qenë kryetar bashkie, ai bëhet në territor, bëhet me qytetarët, nuk bëhet në zyrat e bashkisë apo jo, zoti Likaj, që do të thotë se për vetë parimin e konsultimit publik, ne duhet të jemi në territor.

Tani ta menaxhojmë pak këtë proces siç duhet, ta drejtojmë, sepse mendoj që, edhe nga eksperiencia e kaluar, nëse ne bëjmë dy palë takime, një takim teknik në selinë e Kuvendit dhe një takim me komunitetin më pas, krijohet edhe një lloj kaosi për sa i përket informacionit, për sa i përket ballafaqimit që mund të bëjmë, nëse këtë agjendë do ta ndjekim në një territor. Nëse ne kemi një agjendë të përqendruar në një territor, kemi mundësi t’i kemi të gjitha argumentet teknike. Jam totalisht kundër idesë që ne nuk duhet të ndjekim opinionet apo konkluzionet, që kanë ata që japin shërbime, sepse jam e sigurt, po e përmend si shembull një rast: nëse flasim për emergjencat civile dhe zjarrfikëset, do të kemi një informacion shumë të madh nga të gjithë kryetarët e bashkive dhe duhet t’i dëgjojmë ata për të gjitha ato që nuk shkojnë.

Për sa i përket pjesës së metodologjisë së ekspertëve, ata kanë punën e tyre për të krahasuar të dhënat, që janë fakte, numra dhe shifra zyrtare, që do të thotë se puna mund të bëhet paralelisht për të pasur konsultimin publik, ndërkohë që ekspertët bëjnë atë që quhet *desk research*. Kjo është metodologjia kur ne duam të bëjmë një dokument të plotësuar dhe më pas i ballafaqojmë të dhënat.

Do të doja të bëja një koment, zoti Boçi, për sa u përket ekspertëve. Ju po i paragjykoni edhe ekspertët tuaj, ndërkohë që këtu jam në mbrojtje të ekspertëve tuaj, sepse nga eksperiencia me pushtetin vendor në Ministrinë e Brendshme, di që edhe nga ana juaj ka ekspertë shumë të mirë, të cilët, përtej përkatësisë politike që kanë, janë shumë të drejtë kur vjen puna për pushtetin vendor. Kështu që, do të doja që, ashtu siç i vlerësoj shumë ekspertët nga ana juaj, duke përfshirë edhe zotin Teliti që e kam pasur koleg në këshillin bashkiak, edhe ekspertët nga ana jonë të mos paragjykohen në këtë proces. Janë aty për të ndihmuar procesin, nuk kanë çfarë të shtrembërojnë. Nuk po jua jap këtë si kritikë, thjesht duhet t’i konsiderojmë të gjithë si një grup që mbështet punën tonë dhe ato që duam t’i kemi sa më të sistemuara.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Të falënderoj shumë!

Por nuk e di se ku e dëgjove që unë pata mosvlerësim, po e quaj, nuk po përdor fjalën tuaj, se e quaj fyese atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ju ndërpreva! Madje nuk e di a më dëgjuat me vëmendje se që në fillim kërkova që ekspertët, po i referohem fjalës sime, pra cilësova që ekspertët duhet të zyrtarizohen, të jenë një grup i përbashkët.

E paske marrë nga e kundërta, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti di se çfarë kam thënë unë apo unë di se çfarë kam thënë?!

Se këtu është debat shumë i fortë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më duket se, kur folët ju, ju dëgjova me vëmendje, m'u drejtuat dhe nuk reagova. Po i referohem asaj që thashë. Kërkova të zyrtarizohen, sepse ishte parashikuar një reagim i dy bashkëkryetarëve me ekspertët, të njihen edhe me njëri-tjetrin, sepse gjykoj që puna e ekspertëve duhet bërë bashkë, jo të ndarë ata të PD-së veç dhe të PS - së veç, sepse janë ekspertë, por, siç duket, e ke marrë nga kuptimi i kundërt, sepse, ndoshta, ka qenë fillimi i mbledhjes dhe përqendrimi lëviz në kohë gjatë mbledhjes.

Jam shumë i qartë dhe dua të them edhe diçka tjetër, jo për të diskriminuar kënd, por vlerësimin tim për ekspertët e mi e kam shumë të lartë dhe them se janë ekspertët më të mirë. Nuk hezitoj ta fsheh një gjë të tillë, se dukesh sikur po m'i mbroje ti ekspertët. Ndoshta ishte pjesë e fantazisë suaj. Unë nuk shpreha një vlerësim të tillë për ekspertët.

Romina Kuko – Jo, zoti Boçi, unë dua që pjesën e ekspertëve të mos e paragjykojmë.

Luçiano Boçi – Nuk e paragjykojmë fare.

Romina Kuko – T'i lëmë ata të bëjnë punën e tyre, pa asnjë lloj hije presioni nga ana jonë.

Luçiano Boçi – E ke keqkuptuar.

Romina Kuko – Nuk e kam keqkuptuar, ishte shumë e qartë.

Luçiano Boçi – Të lutem, mos ndërhy, sepse duhet ta mbyll unë fjalën, që ta marrësh ti! Besoj se e ke mësuar këtë rregull elementar të funksionimit të komisioneve.

Kam paragjykuar?! Po, stafet teknike që vijnë nga bashkia. Këtu është keqkuptimi yt, jo ekspertët e përcaktuar nga ne. Mos gabo! Stafet teknike janë politike, janë emëruar politikisht dhe janë emërime politike rixhide. Këtë e kam thënë, e them dhe e përsëris, por jo për ekspertët. Më vjen keq! Nuk u jam referuar në asnjë moment ekspertëve tuaj, fare! Thashë që vlerësimin më të madh dhe besimin më të madh e kam për ekspertët e mi. Më detyruat ju ta shpreh, se për etikë edhe këtë nuk duhet ta shpreh,

por për të hedhur poshtë një keqkuptim, nuk po them gënjeshtër, sepse nuk është gënjeshtër, por është keqkuptim.

Arbjan Mazniku – Zoti Bozdo, meqenëse e bëtë ju propozimin, nëse do të bënim takimin ditën e premte, kë do të ftonit, praktikisht? Ne kemi bërë një agjendë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, që ta kuptojmë propozimin, duhet të themi se si do të funksiononte, sepse arsyeja pse po bëjmë debat, është se propozimi ynë është i detajuar deri në orare. Debatu u bë: a duhet një orë apo një orë e gjysmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kë do të ftojme? Jo emrin, aktorët, që t'i shikojmë paralel të dyja ushtrimet.

Luçiano Boçi – Zoti Spahia.

Bardh Spahia – Atëherë, të nderuar kolegë, që të kuptohemi dhe të mos e diskutojmë 100 herë, se biem në përsëritje: ne jo vetëm nuk jemi kundër dëgjësave publike në territor dhe të mos e përdorni më, se duket sikur ne jemi kundër dhe po kërkojmë vetëm dëgjesat këtu. Ne jemi për të dyja variantet: dëgjesa publike në territor, plus, po thonë kolegët, mund të jetë një vlerë e shtuar për këtë komision edhe thirrja e disa personave politikë dhe teknikë në nivele të larta të pushtetit lokal edhe për dëgjesa më të ngushta përpara komisionit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund ta konsiderosh, pak a shumë ashtu, por më duket se është fare e qartë.

Përveç dëgjësës publike në territor, që pa dyshim e konsiderojmë jashtëzakonisht të rëndësishme, madje të hapur për të gjithë që shprehin interes të marrin pjesë, kolegët tanë po sugjerojnë edhe dëgjesa pranë komisionit në nivel pak më të përzgjedhur qoftë politik, qoftë teknik. Mund të jenë ish-kryetarë të bashkive, kryetarë të bashkive, drejtorë të drejtorive të ndryshme, ekspertë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni! Ta mbaroj që të respektojmë njëri-tjetrin! Ajo që është më e rëndësishme, duke iu përgjigjur këtij interesi, është nevoja, e thashë që në fillim, e zgjedhjes së vendeve neutrale; nuk mund të shkojë ky komision dhe të bëjë dëgjesa publike në institucionet e bashkisë.

E dyta, në respekt edhe të paritetit që ka në thelbin e tij ky komision, respektimi në njëfarë mënyrë deri në njëfarë pikë edhe i përfaqësimit të personave që do të thirren, do të pranohen në respekt të kapaciteteve të sallave, ku do të zhvillohet, kjo është e rëndësishme. Janë krejtësisht të pajustificueshme dhe pa asnjë produkt në shërbim të

këtij komisioni diskutimet me specialistë të institucioneve të pushtetit vendor të bashkisë, që ju siguroj se nuk kanë lirinë e shprehjes së mendimit, pasi nuk do të gjeni asnjë specialist të secilës bashki të drejtuar nga kjo mazhorancë që të shprehet në kundërshtim me reformën territoriale të vitit 2014, që është edhe thelbi pse jemi mbledhur këtu: nevoja për ndryshim.

Unë e di që ky komision në mbledhjet e mëparshme të tij ka marrë vendim, ka bërë dhe një draftagjendë, ku u janë kërkuar ekspertëve ndihmës të këtij komisioni, të paraqesin një raport-analize mbi reformën e vitit 2014. Nëse e keni me kaq merak çështjen e afateve kohore, pse nuk është gati në tavolinat tona raporti i analizës për reformën e vitit 2014? Mund ta them fare qartë që ishte një reformë e dështuar për sa i përket funksionit real të saj në shërbim të qytetarëve, e cila ka çuar sot në domosdoshmërinë e kërkesës për një ndryshim të kësaj reforme dhe pa analizën e së cilës ne nuk mund të shkojmë të ballafaqohemi me dëgjesat publike me qytetarët.

Nëse duam të jemi korrektë, po ju siguroj dhe ju garantoj se nuk ka asnjë lloj benefiti të shkojmë dhe t'i dëgjojmë specialistët e institucioneve politikisht të drejtuara, që nuk kanë kurajën, dhe i mirëkuptoj, të shprehin asnjë lloj pakënaqësie për sa i përket situatës aktuale...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është fyerje, madje e them me keqardhje të madhe.

Më fal, unë u qaj hallin atyre, nuk është fyerje, është shqetësim që kam për ta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju siguroj që kanë pasur liri ku e ku më shumë.

Nuk është kërcënuar ndonjë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos hyni në këto diskutime, sepse janë të gjata!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse është realiteti, nëse nuk ju pëlqen realiteti atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po i kthehem prapë nevojës së respektimit të thelbit që ka dëgjesa publike me dyer të hapura për qytetarët. Edhe kjo në njëfarë mënyre dëgjesë publike është, por nuk po kërkojmë këtë besoj, as nuk po kërkojmë një dëgjesë në nivel ekspertësh, nëse themi: dëgjesë publike, ne kuptojmë nevojën për t'i dhënë zë opinionit të qytetarëve dhe jo vetëm të qytetit, por edhe të njërive administrative, që mbulojnë bashki të caktuara, dhe komplet qarkut.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Meqenëse këtu u hodh sfida që ta nisim ditën e premtë dëgjuesën dhe me kë do ta nisim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja se si do të ishte, sepse e tha edhe zoti Dule, dhe nuk dua t'ia marr autorësinë, pasi e tha shumë qartë: duhet të thërrasim ministrin e linjës dhe është shumë logjike që *start*-i të jetë me ministrin e linjës, të japë edhe ai konceptin e tij të qeverisë për reformën aktuale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta bëjmë, sigurisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku - Nëse doni, i themi ta ndërpresin lidhjen *live* dhe të bëjmë mbledhje pune, të bëjmë planin e punë. Nuk mund të themi që të bëjmë një takim të premtën, pastaj të shohim se çfarë do të bëjmë të hënën. Më sillni një dokument të shkruar, ose ta flasim tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është propozimi ynë, na sillni një propozim tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ma shkruaj.

Luçiano Boçi – Fjala për zotin Bozdo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Malaj, fjala për ju.

Agron Malaj – E kuptoj shumë mirë që po e bëjmë: e lagu, nuk e lagu, dhe nuk duam ta bëjmë këtë lloj procesi që kemi nisur. Nëse nuk duam ta bëjmë, ne e nisim nga ana jonë, por jo të themi: kryetarët e bashkive. Kryetarët e bashkive janë njerëz të nderuar, që kanë marrë më shumë vota se unë e zoti Bardhi dhe se shumë e shumë deputetë apo kryetarë këshillash qarku e deputetë të tjerë, kështu që mund ta bëjmë me ata...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, sepse nuk të ndërpreva kur fole ti!

Nëse nuk e keni me dëshirë, nuk kemi nevojë t'i hedhim topin njëri-tjetrit, e lagu, s'e lagu, e lëmë fare, ne bëjmë procesin tonë, ju vazhdoni procesin tuaj siç e keni, dhe kaq. Këshillat apo ambientet e këshillave bashkiakë janë të popullit, jo të kryetarëve të bashkive, janë të komunitetit, është një parlament i vogël, që ka një pushtet vendor

atje, dhe ne mund t'i bëjmë mbledhjet atje, nuk kemi pse të impresionohemi kaq shumë, se po shkojmë te bashkitë dhe kushedi se çfarë do të ndodhë. Asgjë, do të shkojmë atje dhe do të diskutojmë pikat. A doni të diskutojmë pikën e parë përpara? Dakord, bëjmë dëgjuesën publike me popullin, pastaj vazhdojmë me radhë, heqim edhe drekat e punës, sepse e kemi shumë problem, meqë jemi në dietë unë dhe zoti Bozdo.

Nuk duhet të fillojmë të bëjmë kështu. Nëse nuk jeni dakord, le të dalim me një propozim tonin, që ne e duam kështu dhe të shkojmë në komunitet për respekt të atyre njerëzve, sepse nuk kemi pse i thërrasim këtu, ky është Komision për Reformën Territoriale, jo komision hetimor, që t'i pyesim para një këshilli.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndoshta ju ka marrë malli t'ju shohin atje, sepse nuk ju shohin fare. T'ju shohin dhe t'ju takojnë dhe t'i shihni pak më afër.

Luçiano Boçi – Zoti Bozdo, fjala për ju.

Enno Bozdo – A ka njeri tjetër që do të flasë, sepse po kërkoj të flas për herë të tretë?

Luçiano Boçi – Kush e do fjalën nga mazhoranca?

Po, zoti Jahaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të vazhdojë?

Enno Bozdo – Unë dua ta thjeshtëzoj.

Mosdakordësia jonë është në thelbin e një problemi, që është absolutisht i tejkaluëshëm. Ne perceptojmë se vajtja atje për të folur me kryetarin e bashkisë dhe për të bërë një seancë një orë e gjysmë për disa probleme, që janë shumë të rëndësishme, dhe për t'u ndarë në disa grupe këtej apo andej, është joefikase, joefikase për kohën që shpenzojmë, sepse shpenzojmë kohë për të shkuar deri atje, sepse të jeni të sigurt, që, nëse duam t'i bëjmë takimet sipas agjendës që keni sjellë ju, nuk e menaxhojmë dot kohën.

Për këtë arsye erdhëm me një propozim, ndaj morëm 10-15 minuta kohë, që të kemi mundësi t'i prekim të dyja: a) të bëjmë konsultime dhe dëgjesa publike të mirëfillta, që në rastin më të mirë do të jenë 2 ose 2 orë e gjysmë, ndoshta më shumë, pavarësisht se në agjendë e kemi vetëm një orë e gjysmë (pra, që do të shkojmë në qarqe kjo është e padiskutueshme, sepse nuk ka kuptim ndryshe), b) në mënyrë që të kemi më shumë kohë të komunikojmë me zyrtarët, me ish-zyrtarët, me njerëzit që e dinë dhe me ekspertë, të cilët do t'i vendosim bashkë, të kemi një mundësi që ta luajmë këtu, siç tha

zoti Dule, të jemi të tërë ose një pjesë jona, sepse ndoshta nuk do të qëllojë të jemi të gjithë, të bëjmë pyetjet e duhura, të marrim përgjigjet e duhura dhe të mund të thellohemi në atë gjë.

Kur mund të fillojmë? Mund të bëjmë një plan pune dhe të fillojmë që të premtën me një dëgjuesë me ministrin, siç e tha zoti Dule, ose mund të fillojmë të hënën, ose të martën, por jo më larg se kaq.

Me kë do ta fillojmë? Me të gjithë ata që do ta fillonim ndryshe, thjesht t'i lajmërojmë që të vijnë këtu. Në vend që të bëjmë një mbledhje, ku të shkojmë 7 veta për të takuar 15 veta në mjediset e bashkisë, jemi këtu dhe kemi mundësi që, vetëm me rrugën që mund të kursejmë, pa llogaritur të gjitha të tjerat, të bëjmë 3 ose 4 orë më shumë aktivitet, dhe në fund të ditës është shumë më bukur dhe më mirë kështu. Pse? Edhe për transparencë ndaj publikut, sepse të jeni të sigurt se nuk do të transmetohet asgjë po shkuam gjithandej, kurse këtu transmetohet. Duhet t'i dëgjojmë njerëzit. Thelbi është ku do t'i takojmë këta njerëz. Ne kemi bërë 3 orë debat vetëm se ku do t'i takojmë. Ne mendojmë se është shumë më efektive këtu, dhe nuk po shpikim ndonjë gjë, as po propozojmë diçka ta paparë më parë. Komisioni i mëparshëm për Reformën ka bërë të njëjtën gjë, komisionet e tjera i thërrasin në seancë dëgjimore palët e interesit, jo dëgjesa publike të mëdha, që janë të detyrueshme, dhe do të ndodhin në të gjitha rastet pranë komuniteteve.

Po them që t'i japim seriozitet kësaj gjëje, dhe të marrim pak më shumë kohë, jo më shumë ditë, brenda së njëjtës ditë, për të pyetur më shumë, për të folur më shumë dhe për t'u shkuar deri në fund çështjeve. Nuk na shqetëson më shumë nëse do të shkojmë në Tiranë, në Elbasan, në Durrës ose në Berat apo që do të vijnë ata këtu, të jeni të sigurt që koha jonë është shumë më e ngjeshur se koha e tyre. Përpara një komisioni parlamentar jo hetimor është detyrë, sepse para një komisioni hetimor është akoma më shumë detyrë, të vijnë dhe të marrin 2 ose 3 orë nga dita e tyre për të dëshmuar përvojat e tyre. Kaq e thjeshtë është. Pse duhet ta komplikojmë kaq shumë? Këtu hidhen teza sikur nuk duam, jo, duam dhe pikërisht sepse duam, vijmë me një propozim alternativ, që ta bëjmë më mirë dhe mos humbim kohë fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po qe puna për shpenzimet...

Arbjan Mazniku – Bashkëkryetar, të lutem!

Enno Bozdo - Po shpenzimet e drekës kur shkojmë atje kush i paguan?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Kërkoj të bëjmë 10 minuta pushim, që të bëjmë një diskutim jashtë mbledhjes me bashkëkryetarin, për të rënë dakord për një modalitet dhe më pas të rimblidhemi.

Luçiano Boçi – Qëllimi është që ne, si bashkëkryetarë, të konsultojmë nesër agjendën mujore të dëgjësave që do të organizojmë, duke i konsideruar të dyja propozimet që vijnë edhe nga mazhoranca, edhe nga opozita.

Besoj se jeni dakord dhe ta mbyllim sot mbledhjen.

Bardh Spahia – A mund te them diçka shumë shkurt?

Luçiano Boçi – Po, patjetër.

Bardh Spahia – Dëgjova shprehjen: “Po punojnë paralelisht ekspertët”, ekspertët punojnë, na sjellin ne draftin, ne bëjmë sugjerime, ua çojmë prapë dhe ata mund të na e kthejnë prapë. Kështu funksionon në çdo institucion. Nuk mund të pranojmë që ekspertët të punojnë paralelisht, sepse shkojnë në dy drejtëza që nuk takohen pastaj.

Arbjan Mazniku – Mendoj se ekspertët do të fillojnë punë formalisht pas miratimit në Byro të kërkesës që është çuar nga komisioni, sepse komisioni në mbledhjen e fundit i ka çuar Byrosë kërkesën, me emrat specifikë të ekspertëve. Duke qenë se ekspertët janë propozuar disa nga mazhoranca dhe disa nga opozita, me të drejtë secili prej nesh u ka thënë njerëzve që të fillojnë të lexojnë, të studiojnë, të shohin raportin dhe dokumentacionin, që të bëjnë punë paraprake, duke qenë se ky është një hap tjetër formal.

Kur bashkëkryetari tha që po punojnë paralelisht, do të thotë që kanë filluar të lexojnë, por nuk na kanë sjellë akoma një produkt, do të na e sjellin kur të fillojnë formalisht. Do t’i mbledhim të gjitha ditën e nesërme pas miratimit formalisht të tyre në Byro, do t’i ftojmë këtu formalisht në mbledhje të komisionit.

Për sa i përket agjendës, dakordësia që patëm me bashkëkryetarin është të bëjmë një bisedë teknike gjatë ditës së nesërme për të dakordësuar një agjendë, që të përmbajë edhe propozimin e opozitës për të bërë disa dëgjesa këtu, edhe propozimin tonë për të bërë një seri dëgjesash atje. Unë i lashë kryetarit të kuptojë që, në respekt të kërkesës së mazhorancës për të bërë disa dëgjesa këtu, nëse kjo çështje do të jetë e domosdoshme për dëgjesë këtu, grupi socialist ruan të drejtën të bëjë dëgjesa paralele në territor, që i sheh të arsyeshme, sikurse edhe grupi i opozitës ka të drejtë të bëjë dëgjesa të tjera. Ato që janë formale dhe nëse duam t’i bëjmë këtu, pasi kjo është kërkesa, i bëjmë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Vangjel Dule – Të nderuar bashkëkryetarë, do të duket skolastike, më falni, sepse janë të gjithë të lodhur dhe duan të largohen, por nuk e shprehët qartë qëndrimin tonë. Nuk thamë që ne nuk duam, sepse këto janë përshtypje që përpiqeni t'i kultivoni, nuk thamë të mos bëhen dëgjesa publike, ne thamë dëgjesë edhe këtu, edhe dëgjesa publike në terren. Nuk e kemi përjashtuar, të jetë e qartë, sepse po përpiqeni të krijoni përshtypje për qëndrime që nuk ekzistojnë.

Ju faleminderit!

Arbjan Mazniku – Kërkesa që i bëra bashkëkryetarit ishte që të merrni kohën të shkruani planin e të gjithë muajit, siç e mendoni ju, ne e kemi shkruar si e mendojmë. Ne mendojmë që ditën e hënë të takohemi me ata të Shkodrës me 10, 12 apo 13 aktorë dhe ditën e mërkurë të thërrasim ata të Lezhës. Si do të jetë formula, që ta dimë ekzaktësisht? Pra, të bëjmë një plan të të gjithë muajit dhe të biem dakord. Ne kemi bërë një propozim se cilët janë aktorët që ne gjykojmë se duhen thirrur ose që duhen takuar, pastaj modalitetin le ta diskutojmë, nuk kam asnjë problem. Por, ne gjykojmë se grupimi i njerëzve që kemi parashtruar në listën që ju ndamë, janë njerëz që duhen të dëgjohen nga komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka problem, sepse dëgjojmë ne, nëse nuk doni ju, këdo që nuk doni të dëgjoni ju, e dëgjojmë ne.

Pjesa e dytë është të mos miratojmë një takim të radhës, por një agjendë të gjithë punës së muajit, t'u japim kohë njerëzve, t'i lajmërojmë dhe t'i pyesim nëse do të vijnë, apo do të shkojmë në këtë datë, dhe ta dinë njerëzit më parë, që të bëjnë plane, sepse dikush mund të ketë një udhëtim, dikush nuk është këtu, dikush nuk mundet atë ditë, sepse ka mbledhje të këshillit bashkiak, pra të rregullojmë agjendat me të gjithë, që t'u japim mundësi njerëzve të bëjnë punën që duhet.

Luçiano Boçi – Duke konsideruar dëgjesat publike me komunitetet që i kanë kërkuar tashmë, por edhe si parashikim, për të caktuar data të lëna si opsione për kërkesa që do të na vijnë në vazhdimësi qoftë në faqen e komisionit, qoftë në adresat tona, apo në rrjetet sociale. Duhet t'i konsiderojmë edhe këto, megjithëse unë pretendoj që komunikimi të jetë në faqen zyrtare të Kuvendit.

Kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 27.11.2025, të cilin duhet ta kishim kaluar të parin.

A jeni dakord? A keni vërejtje?

Miratohet.
Mbledhja mbyllet.
Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA